



Republika e Kosovës- Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

RAPORTI I PROGRESIT

I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TË DREJTAT
E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2021-2023

RAPORTI I PROGRESIT 2023





Republika e Kosovës- Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

RAPORTI I PROGRESIT

I PLANIT TË VEPRIMIT PËR TË DREJTAT
E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2021-2023

RAPORTI I PROGRESIT 2023

Pëmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
QËLLIMI I RAPORTIT	6
METODOLOGJIA	7
I. DOKUMENTET BAZË PËR PËRPILIMIN E RAPORTIT TË PROGRESIT	8
1.1 Strategjia Nationale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2013-2023)	8
1.2 Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2023	9
II. MEKANIZMAT PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM	10
2.1 Institucionet e involvuara në procesin e monitorimit të planit nacional për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës	11
III. ANALIZA E ARRITJEVE DHE PËRBALLJEVE ME SFIDAT NË RAPORTIN E PROGRESIT - VËSHTRIM I DETAJUAR.....	13
1. SHËNDETËSI.....	13
2. MIRËQENJA SOCIALE DHE PUNËSIMI	22
3. ARSIMI	31
4. MBROJTJE LIGJORE.....	40
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	56

LISTA E SHKURTESAVE

ZKM/ZQM	Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë
ASK	Agjencioni i Statistikave të Kosovës
DKA	Departamenti Komunal i Arsimit
DMS	Departamenti i Mirëqenies Familjare
MASHTI	Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diaspores
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MZHR	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MBZHR	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MD	Ministria e Drejtësisë
PNV	Plani Nacional i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2009-2011
PIA	Plani individual i edukimit
KE	Komisioni Evropian
OJQ	Organizata Jo qeveritare
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
KD për Personat me Aftësi të Kufizuar	Konventa për të Drejta e Personave me Aftësi të Kufizuara
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
O për Personat me Aftësi të Kufizuar	Organizata për Personat me Aftësi të Kufizuara
QZHMF	Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtave e Njeriut
QB	Qendra Burimore
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
ZP	Zyra e Punësimit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është thelbësore për të siguruar që këta persona të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Duke siguruar mbrojtjen e të drejtave të tyre, mund të ndihmojmë në evitimin dhe zvogëlimin e barrierave me të cilat ballafaqohen Personat me Aftësi të Kufizuara duke u mundësuar atyre të jenë pjesë e integruar dhe e barabartë e shoqërisë në të gjitha sferat e jetës.

Sipas nenit 24, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”*. Sipas nenin 47 të Kushtetutës, paragrafi 2 përcaktohet se: *“Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj”,* gjersa në nenin 51, paragrafi 2 përcaktohet shprehimisht se: *“Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj”*.

Për më tepër, mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është çështje e drejtësisë sociale dhe e të drejtave të njeriut. Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në nenin 17, paragrafi 1 përcakton se *“Çdo person me aftësi të kufizuar ka të drejtën e respektit ndaj integritetit të saj/ tij fizik dhe mendor njësoj si pjesa tjetër e popullsisë”*.

Sigurimi i mbrojtjes së të drejtës në arsim, punësim, shëndetësi dhe akses në hapësira është thelbësore për respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit dhe vlerës së çdo individit, parvarësisht nga aftësitë e tij, duke synuar eliminimin e diskriminimit dhe paragjykimëve. Vetëm një shoqëri gjithëpërfshirëse ku të gjithë kanë mundësi dhe të drejta të barabarta mund të shprijë në stabilitet dhe harmoni më të madhe shoqërore.

Duke u bazuar në angazhimin dhe kontributin e Institucioneve të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, është hartuar Raporti i Progresit për zbatimin e “Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023” (“këtu: Raporti”).

Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërkombëtar ka mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira, duke krijuar një bazë të fortë për progres të mëtejshëm dhe për arritjen e objektivave tona të përbashkëta, Prandaj, shprehim mirënjohje të thellë ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës dhe akterëve ndërkombëtarë për kontributin e tyre të çmuar në ofrimin e të dhënave dhe bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Angazhimi dhe përkushtimi i tyre ka qenë jetik në hartimin dhe zbatimin e politikave efektive që synojnë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

QËLLIMI I RAPORTIT

Qëllimi i hartimit të këtij raporti është të dokumentojë progresin e arritur gjatë vitit 2023 lidhur me zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara me “Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës 2021-2023”.

Hartimi i raportit të progresit ka një rëndësi të veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes së efektivitetit të politikave dhe programeve të miratuara. Ky raport është një mjet kyç për vlerësimin e përparimit drejt objektivave të përcaktuara, duke siguruar që përpjekjet dhe burimet e alokuara po përdoren në mënyrë të duhur dhe po sjellin përmirësimet e dëshiruara në jetën e personave me aftësi të kufizuara. Përmes një raporti të detajuar dhe të besueshëm, institucionet dhe organizatat mund të identifikojnë zonat ku progresi është i ngadaltë ose mungon, dhe të ndërmarrin veprime konkrete në kohë reale.

Raporti i progresit luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucioneve që janë përgjegjëse për zbatimin e planit të veprimit. Ai ofron një bazë për të komunikuar me publikun dhe palët e interesit mbi arritjet dhe sfidat e hasura gjatë implementimit. Ai mund të identifikojë praktikatat më të mira dhe të sugjerojë strategji dhe objektiva të reja për të adresuar sfidat që janë identifikuar gjatë zbatimit të planit. Kështu, raporti mund të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të qasjes dhe mekanizmave që zbatohen për të mbështetur Personat me Aftësi të Kufizuara. Në një perspektivë më të gjerë, raporti i progresit ndihmon në forcimin e angazhimit të institucioneve ndaj të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke përforcuar rëndësinë e përfshirjes sociale dhe barazisë. Përmes monitorimit dhe vlerësimit të rregullt, institucionet mund të sigurohen që politika dhe programet e tyre janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare. Kjo jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuara në nivel lokal, por edhe kontribuon në përpjekjet globale për barazi dhe përfshirje sociale.

METODOLOGJIA

Zyra për Qeverisje të Mirë ka rol kyq në procesin e koordinimit, monitorimit dhe vlerësimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit. Vlerësimi i progresit kundrejt objektivave të strategjisë dhe objektivave të matshme është një periudhë vendimtare e analizave dhe ecurisë së veprimeve, duke u mbështetur në përmirësimin e mëtejshëm të politikave dhe praktikave aktuale. Ky proces kompleks garanton që strategjia të jetë jo vetëm e zbatueshme, por edhe e përmirësueshme, duke u mbrojtur dhe avancuar të drejtat dhe mirëqenien e personave me aftësi të kufizuara.

Metodologjia e mbledhjes së të dhënave për përpilimin e raportit të progresit mbi zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara përfshin një qasje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar.

Së pari, është e rëndësishme të përcaktohen objektivat specifike të planit të veprimit të cilat duhet të jenë të matshme, të arritshme dhe relevante. Indikatorët për matjen e progresit duhet të jenë të qartë dhe të përshtatshëm për të monitoruar ndryshimet dhe arritjet që janë realizuar gjatë vitit 2023 lidhur me statusin e personave me aftësi të kufizuara. Këta indikatorë mund të përfshijnë aksesin në shërbime, mundësitë për punësim, edukimin, infrastrukturën e përshtatshme, dhe përfshirjen e tyre sociale.

Mbledhja e të dhënave është një komponent thelbësor i metodologjisë së këtij raporti duke përdorur burime të ndryshme të të dhënave për të siguruar një pamje gjithëpërfshirëse të progresit. Këto burime përfshijnë anketa, intervista, raporte administrative, dhe të dhëna statistikore nga institucionet relevante. Është e rëndësishme që të dhënat e besueshme janë mbledhur në mënyrë sistematike për të garantuar validitetin dhe besueshmërinë e raportit.

Pas mbledhjes së të dhënave, hapi tjetër është analiza e tyre që përfshin krahasimin e të dhënave aktuale me objektivat e përcaktuara në planin e veprimit. Metodologjitë statistikore dhe analitike do të ndihmojnë në identifikimin e trendëve, zbrazëtirave dhe arritjeve në implementimin e planit. Analiza cilësore, përmes intervistave dhe komenteve të përfituara nga grupet e interesit, gjithashtu mund të japë perspektiva të vlefshme mbi sfidat dhe përparësitë.

Raporti i progresit është strukturuar qartë dhe në mënyrë logjike duke përfshirë një përmbledhje ekzekutive, prezantimin e metodologjisë, rezultatet kryesore të analizës, diskutimin mbi arritjet dhe sfidat, si dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm. Dokumentimi i detajuar i metodologjisë dhe burimeve të të dhënave është thelbësor për transparencë dhe për të mundësuar që raporti të jetë i riprodhueshëm në të ardhmen.

Gjatë gjithë procesit të mbledhjes dhe analizimit të dhënave, janë përfshirë palët e interesit, përfshirë Personat me Aftësi të Kufizuara, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të tyre, dhe institucionet qeveritare dhe joqeveritare. Konsultimi dhe feedback-u nga këto grupe siguron që raporti të reflektojë në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në terren dhe nevojat e komunitetit të personave me aftësi të kufizuara.

Përdorimi i kësaj metodologjie të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse do të ndihmojë në krijimin e një raporti të progresit të detajuar dhe të besueshëm, i cili do të shërbejë si një mjet i rëndësishëm për monitorimin dhe përmirësimin e planeve të ardhshme për përfshirjen dhe mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara.

I. DOKUMENTET BAZË PËR PËRPILIMIN E RAPORTIT TË PROGRESIT

1.1 Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës (2013-2023)

Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është një dokument i rëndësishëm që synon përmirësimin e kushteve të jetesës dhe garantimin e të drejtave për këtë kategori të popullsisë. Kjo strategji është e ndarë në pesë (5) objektiva strategjike kryesore, secili prej të cilëve përqendrohet në aspekte specifike të mirëqenies dhe përfshirjes sociale të Personave me Aftësi të Kufizuar.

Objektiva Strategjike 1: përqendrohet në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Ky objektiv synon të sigurojë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore të nivelit primar, sekondar dhe terciar, përmes një politike koherente që përfshin parandalimin, zbulimin e hershëm dhe identifikimin e sëmundjeve, si dhe ofrimin e shërbimeve të specializuara mjekësore dhe të infermierisë në kujdesin hospitalor.

Objektiva Strategjike 2: ka për qëllim krijimin e një sistemi funksional dhe të mirëfilltë për mirëqenien dhe sigurinë sociale, si dhe ofrimin e mundësive të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar. Duke u bazuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara, kjo objektive përfshin përmirësimin e cilësisë së jetës për Personat me Aftësi të Kufizuar, veçanërisht për gratë dhe të moshuarit si kategori e cila konsiderohet më e rrezikuar në shoqëri, dhe reduktimin e varfërisë përmes rritjes së punësimit dhe sigurimit të kushteve të barabarta në tregun e punës.

Objektiva Strategjike 3: synon krijimin e kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe mbështetjen profesionale për Personat me Aftësi të Kufizuar. Kjo objektive siguron të drejtën për edukim pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, duke përfshirë mësimin sipas planeve individuale të arsimit, arsimin profesional dhe mbështetjen e vazhdueshme për profesionistët që punojnë me Personat me Aftësi të Kufizuar.

Objektiva Strategjike 4: përqendrohet në krijimin e infrastrukturës ligjore për respektimin dhe përmbushjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar. Kjo përfshin promovimin dhe vetëdijësimin për të drejtat e tyre, rishikimin e legjislacionit nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e qasjes së barabartë në organet e drejtësisë për Personat me Aftësi të Kufizuar, për të garantuar pjesëmarrjen efektive të tyre në të gjitha procedurat ligjore.

Objektiva Strategjike 5: synon krijimin e kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim dhe pjesëmarrje për Personat me Aftësi të Kufizuar, duke krijuar një sistem të unifikuar të të dhënave. Kjo objektive përfshin përmirësimin e pengesave fizike dhe të komunikimit, përmirësimin e infrastrukturës urbane dhe sigurimin e qasjes në informacion dhe teknologji. Gjithashtu, synon të garantojë pjesëmarrjen e plotë dhe të barabartë të Personave me Aftësi të Kufizuar në jetën politike, publike, kulturore dhe sportive.

Në përgjithësi, kjo strategji synon të përmbushë të gjitha nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuara për një jetë të denjë dhe të barabartë në Republikën e Kosovës, duke siguruar që të drejtat e tyre të respektohen dhe të mbrohen në të gjitha sferat e jetës.

1.2 Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2023

Bazuar në Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është hartuar Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023, ku ky dokument paraqet vazhdimësinë e veprimeve dhe politikave në nivel vendi për zbatimin e objektivave strategjike të përcaktuara në Strategjinë Nacionale.

Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 është plani i tretë në kuadër të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023 në nivel vendi, dhe në çdo aspekt ka për qëllim të avancoj çdo herë e më shumë të drejtat e personave me aftësi të kufizuar deri në arritjen e një synimi final për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse në të cilën Personat me Aftësi të Kufizuar realizojnë potencialin plotë të tyre dhe kanë të drejtën të jetojnë një jetë të dinjitetshme.¹

Aktivitetet dhe objektivat e përcaktuara në planin e veprimit janë hartuar në pajtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e cila përcakton shprehimisht fushat kryesore si: respekti për dinjitetin njerëzor, autonominë individuale për të vendosur dhe zgjedhur, mungesa e diskriminimit, përfshirja e plotë në shoqëri, respektimi i dallimeve, mundësitë e barabarta, qasja e lirë dhe pa pengesa, barazia gjinore e mbrojtja e identitetit.

Çdo veprim i paraqitur në kuadër të Planit Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2021-2023 është punuar në bashkëpunim me organizatat për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe në bashkëpunim me Projektin e financuar nga BE-ja, i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë zbatuar nga: Handikos, në partneritet me SHKSH, SHVK, DPF Threshold “Promovimi gjithëpërfshirës në proceset konsultative për reformat e qeverisjes dhe administratës publike në sektorin e aftësisë së kufizuar në nivel lokal, nacional dhe regional” në miratim të plotë nga institucionet përgjegjëse përkatësisht ministritë e linjës të cilat zotohen në realizimin dhe përmbushjen e aktiviteteve konform afatit të zbatimit dhe kostos së realizimit të aktiviteteve.

Si përfundim, Republika e Kosovës me Planin Nacional për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2021-2023, ka për mision të jetësoj të gjitha veprimet e përcaktuara në këtë dokument në mënyrë që jeta e personave me aftësi të kufizuar të përmirësohet edhe më tej.

Duke u bazuar në monitorimin e realizimit të objektivave strategjike, institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe lokal si dhe shoqëria civile kanë kontribuar në ndërmarrjen e veprimeve konkrete drejt zbatimit të objektivave përkatëse.

Prandaj, duke u bazuar në “Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023” dhe “Planin Nacional të Veprimit (2021-2023) prezantohet Raporti i Progresit”. Ky raport synon të pasqyroj një analizë të detajuar të arritjeve dhe sfidave të hasura gjatë periudhës së raportimit, duke përdorur tregues të matshëm për të vlerësuar përparimin në secilin objektiv strategjik. Gjithashtu, raporti ofron rekomandime për përmirësimin e politikave dhe praktikave ekzistuese. Për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie, raporti përfshin inputet e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë institucionet në nivelin qendror dhe lokal, shoqërinë civile dhe vetë Personat me Aftësi të Kufizuara.

1 Shih: *Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2023*

II. MEKANIZMAT PËR MONITORIM, RAPORTIM DHE ZBATIM

Këshilli Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar është themeluar për krijimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar, të siguroj që nevojat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuar të merren gjithmonë parasysh kur Qeveria sjell vendime mbi çështjet që ndërlidhen me gjendjen e personave me aftësi të kufizuar. Si rrjedhojë Këshilli Nacional mbi Aftësinë e Kufizuar përcjellë, monitoron dhe shqyrton kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe këshillon Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për Personat me Aftësi të Kufizuar. Dhe si përfundim e gjithë puna e këtij mekanizmi është në përputhje dhe përmbushjen e objektivave strategjike të këtij dokumenti.²

Në vitin 2021 ky Këshill është ri-emëruar si “Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuara” me rastin e ri-themelimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës si organ këshillëdhënës dhe orientues mbi përcaktimin e prioritetëve dhe politikave në fushën e aftësisë së kufizuar. Këshilli, varësisht nga nevojat krijon grupe punuese, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me akterë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtar. Është përcaktuar se Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuara mund të iniciojë dhe të marrë pjesë aktive në hartimin dhe zhvillimin e politikave të reja që kanë të bëjnë me çështjet e aftësisë së kufizuar si dhe mund t'i propozojë rekomandime Qeverisë së Republikës së Kosovës.³ Këshilli përbëhet nga 14 anëtarë: Kryesuesi (që është Zv-Kryeministri), Bashkë-kryesuesi (caktohet me rrotacion me mandat 1 vjeçar dhe është person me aftësi të kufizuara), Zv Kryesuesi (Drejtori i Zyrës për Qeverisje të Mirë), 5 (pesë) anëtarë janë Zv. Ministrat e Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Në kuadër të përbërjes së Këshillit 6 (gjashtë) anëtarë janë nga rradhët e shoqërisë civile, përkatësisht nga shoqatat që merren me përfaqësimin dhe mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuar si: HANDOKOS, HANDIKEP Kosova, Shoqata Kosovare e të Shurdhëve, Shoqata e të Verbërve të Kosovës, Down Syndrom Kosova si dhe Shoqata e Autizmit.

Zyra për Qeverisje të Mirë shërben si Sekretariat i Këshillit.⁴

Komisioni për Monitorimin, Raportimin dhe Vlerësimin e Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është një mekanizëm monitorues i ri-mandatuar nga Zyra e Kryeministrit për periudhën 2013 -2023, me përbërjen dhe fushëveprimin e njëjtë me Komisionin paraprak i cili në përbërjen e tij ka të gjithë përfaqësuesit e ministrive kryesore përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit si dhe përfaqësuesit e organizatave që punojnë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Ky mekanizëm koordinues udhëhiqet nga Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë që mban takime të rregullta me qëllim të monitorimit të gjithë procesit të zbatimit të Strategjisë dhe Planeve të Veprimit që do të dalin nga ky dokument.⁵

2 Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023, fq.20

3 Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 13/16, 22.06.2021

4 Rregullat e Punës së Këshillit për Personat me Aftësi të Kufizuar, dt. 29.12.2021

5 Po aty

Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit bazuar në mandatin e kësaj zyre, që nga miratimi i Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka vënë në fokus kryesor monitorimin dhe implementimin e dokumenteve të hartuara të rëndësishme sa i përket fushës së aftësisë së kufizuar. Procesi i monitorimit dhe raportimit lidhur me zbatimin e Strategjisë për Personat me Aftësi të Kufizuara në Republikën e Kosovës dhe Planit të Veprimit dhe ka qenë një mekanizëm thelbësor për të siguruar zbatimin e objektivave strategjike ku Zyra për Qeverisje të Mirë ka luajtur një rol kyç në këtë proces, duke koordinuar dhe mbikëqyrur veprimet e ndërmarra nga institucionet përkatëse dhe akterët e tjerë. Kjo zyrë ka siguruar që të gjitha aktivitetet dhe mekanizmat përkatëse të jenë në përputhje me objektivat strategjike dhe të adresojnë nevojat reale të personave me aftësi të kufizuara, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre dhe garantimin e gjitha të drejtave.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka një kornizë të monitorimit mbi bazën e së cilës bën matjet e progresit, ndërsa institucionet përgjegjëse janë të obliguara të hartojnë plane më të detajuara të veprimit, të cilat ofrojnë hollësi më specifike për secilin departament në kuadër të institucionit përgjegjës. Përmes mekanizmave të avancuar të mbledhjes dhe analizës së të dhënave, Zyra për Qeverisje të Mirë ka monitoruar progresin e arritur në zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë. Këto mekanizma kanë përfshirë grumbullimin e raporteve periodike nga institucionet përkatëse, vlerësimin e ndikimit të politikave të zbatuara dhe identifikimin e sfidave që kanë penguar realizimin e plotë të objektivave. Kjo qasje e vazhdueshme e monitorimit, raportimit dhe vlerësimit ka mundësuar reagime të shpejta për të adresuar problemet dhe sfidat.

Zyra për Qeverisje të Mirë ka rol kyç në sigurimin e një procesi të monitorimit dhe raportimit sistematik dhe efektiv, që kontribuon në përmbushjen e objektivave të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Planit të Veprimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2.1 Institucionet e involvuara në procesin e monitorimit të planit nacional për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës

Procesi i zbatimit të objektivave strategjike të Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2023 ka përfshirë një mori institucione si: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, Komunitat, Organizatat për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe partnerët e tjerë vendor dhe ndërkombëtar. Qëllimi kryesor i gjitha institucioneve të involvuara në proces të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të objektivave strategjike ka qenë përmirësimi i jetës dhe garantimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës. Institucionet e përfshira kanë synuar të krijojnë një mjedis të barabartë, ku çdo individ, pavarësisht aftësive, mund të integrohet në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ekonomike dhe politike. Për të arritur këtë qëllim, është theksuar rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar zbatimin efektiv dhe koherent të politikave dhe masave të parashikuara në plan.

Objektivat specifike të Ministrisë së Shëndetësisë kanë përfshirë përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kjo ka

përfshirë zhvillimin e programeve të specializuara mjekësore, trajnimin e personelit shëndetësor dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme për diagnostikim dhe trajtim.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka punuar për të siguruar qasje të barabartë në arsim për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara, përmes përmirësimit të infrastrukturës shkollore, zhvillimit të kurrikulave dhe trajnimit të mësuesve për të mbështetur nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka luajtur një rol vendimtar në sigurimin e mbështetjes financiare dhe krijimin e mundësive të punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuara. Kjo ka përfshirë zhvillimin e politikave të punësimit të mbështetura nga subvencione dhe trajnime profesionale për të ndihmuar Personat me Aftësi të Kufizuara të integrohen në tregun e punës.

Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe Komunat kanë pasur për detyrë të sigurojnë që planet lokale të zhvillimit të jenë gjithëpërfshirëse dhe të adresojnë nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara në komunitetet e tyre.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka punuar për të përmirësuar qasjen fizike në ndërtesa publike, transport publik dhe hapësira të tjera publike, duke siguruar që këto të jenë të qasshme për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka promovuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në aktivitete kulturore dhe sportive, duke ofruar programe dhe shërbime të dedikuara për të mbështetur përfshirjen e tyre.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përmes subvencioneve dhe granteve ka ndihmuar këta individë në nisjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

Ministria e Drejtësisë, së bashku me Policinë e Kosovës, kanë siguruar që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të jenë të mbrojtura dhe të respektohen në të gjitha sferat e jetës.

Në fazën e raportimit obligohen të gjitha institucionet përgjegjëse (ministritë, komunat agjencitë si dhe institucionet e tjera relevante në vend) që në baza gjashtë mujore ti raportojnë Zyrës për Qeverisje të Mirë/ Zyrës së Kryeministrit për përparimin dhe barrierat e hasura në implementimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Për disa vite UNICEF vazhdimisht ka mbështetur Zyrën e Qeverisjes së Mirë/ Zyrës së Kryeministrit (OGG) dhe Agjencinë së Statistikave të Kosovës (KAS) në forcimin e sistemit të monitorimit të të drejtave të fëmijëve për të paraqitur situatën e fëmijëve në Kosovë, veçanërisht ato nga komunitetet e marginalizuara. Në bashkëpunim me OGG dhe KAS, UNICEF ka filluar zhvillimin e platformës së monitorimit të të drejtave të fëmijëve. Kjo platformë është krijuar për t'u integruar në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit, duke ofruar informacione për fëmijët në Kosovë dhe programe udhëzuese dhe politika që synojnë ruajtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë. Për më tepër, UNICEF ka ofruar ndihmë teknike për të përmirësuar disponueshmërinë e të dhënave dhe mekanizmat e raportimit për treguesit e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo ndihmë ka përfshirë përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe mbështetjen e KAS në përmirësimin e mjeteve të raportimit të përdorura nga ministritë e linjës, të tilla si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për të lehtësuar transmetimin më të butë të të dhënave në KAS.⁶

6 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

III. ANALIZA E ARRITJEVE DHE PËRBALLJEVE ME SFIDAT NË RAPORTIN E PROGRESIT-VËSHTRIM I DETAJUAR

1. SHËNDETËSI

Në kuadër të analizës së arritjeve dhe sfidave në sektorin e shëndetësisë lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit Strategjik 1 synohet përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Për të arritur këtë synim, janë përcaktuar disa objektiva specifike si: ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve cilësore, zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej periudhës prenatale, natale dhe postnatale, si dhe rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara). Të dhënat e analizuara dhe përpunuara reflektojnë përpjekjet dhe sfidat e hasura gjatë implementimit të planit, duke nxjerrë në pah progresin dhe pengesat e përballura.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: PËRMIRËSIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Analiza e objektivit strategjik 1 është bërë përmes një qasjeje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse duke mbledhur të dhëna nga institucione shëndetësore, organizata joqeveritare dhe vetë Personat me Aftësi të Kufizuara për të identifikuar nevojat dhe sfidat ekzistuese në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Rezultatet e kësaj analize janë përdorur për të përshtatur dhe përmirësuar strategjitë dhe politikat e zbatimit, duke siguruar që shërbimet shëndetësore të jenë të qasshme, cilësore dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të Objektivës Strategjike 1 janë paraparë tre objektiva specifike si në vijim:

Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore - objektiv i cili përfshinë 6 aktivitete të parapara të cilat kanë të bëjnë me: 1.1. Ofrimin e shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara në kuadër të vizitave shtëpiake, 1.2 Vaksinimi i personave me aftësi të kufizuara me vaksinë të gripit sezonal, 1.3. Hartimi i materialeve për promovim shëndetësor të personave me aftësi të kufizuar dhe edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor, 1.4 Realizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara 1.5. Trajnime për stafin infermierik dhe stafin mbështetës në tematikat e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar, 1.6. Koordinimi i aktiviteteve me MFPT.

Objektivi specifik I: Ngritja e kapaciteteve te personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore

Aktiviteti I 1.1 *Ofrimin i shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara në kuadër të vizitave shtëpiake*

Treguesi 1: *Raporti i analizës*

Treguesi 2: *Kurrikulat e trajnimeve të stafit mjekësor me specifikat e Personave me Aftësi të Kufizuara*

Progresi i arritur: Lidhur me zbatimin e këtij aktiviteti Ministria e Shëndetësisë raporton se gjatë vitit 2023 në Podujevë 22 persona me aftësi të kufizuara kanë përfituar nga vizita mjekësore nga gjithsej sa kanë qene vizita 901 gjatë tërë vitit- QKMF në Viti ka raportuar se janë plotësuar kartelat shëndetësore për 23 shërbime shëndetësore të ofruara në vizita shtëpiake për Personat me Aftësi të Kufizuara - QKMF në Ferizaj ka raportuar se janë plotësuar kartelat shëndetësore për 125 shërbime shëndetësore të ofruara në vizita shtëpiake për Personat me Aftësi të Kufizuara , duke llogaritur edhe 54 Persona me Aftësi të Kufizuara të tjerë të vaksinuar në lokalet e „HENDIFER-it” dhe „HANDIKOS-it” dhe te Shtëpia Integruese, gjithsejtë janë 179 shërbime shëndetësore të ofruara për Personat me Aftësi të Kufizuara -QKMF në Gjakove ka raportuar se nuk shfrytëzohen kartelat shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara derisa - QKMF Fushë – Kosove ka raportuar se gjatë viti 2023 është realizuar transporti i 30 pacientëve të Personave me Aftësi të Kufizuara ne QKUK. Janë ofruar shërbime të kujdesit paliativ, terapi, këshillim, marrje e gjakut për analiza laboratorike, dhënie e terapisë si dhe këshilla shëndetësore ku figuron se mbi 8361 shërbime janë ofruar në përgjithësi -QKMF në Mitrovicë thekson se nuk është bërë ndarje sipas personave me aftësi të kufizuara. Nga QKMF – Pejë kanë raportuar se nuk shfrytëzohen kartelat shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara , por personave ju sigurohet transporti për në Hemodializë nga QKMF . QKMF në Obiliq kanë raportuar se nuk shfrytëzohen kartelat shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara -derisa në QKMF në Klinë janë plotësuar kartelat shëndetësore për 33 shërbime shëndetësore të ofruara në vizita shtëpiake për Personat me Aftësi të Kufizuara QKMF në Junik në bashkëpunim me QPS Junik gjatë vitit 2023 ka identifikuar dhe realizuar disa shërbime shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara ne territorin e Komunës se Junikut. Raportohet se tash e 3 vite realizohen vizita ne shtëpi për nëna dhe fëmijë ku përfshihet vetëdijesimi dhe detektimi i hershem i aftësisë së kufizuara. Vitin e kaluar ne bashkëpunim me DSHMS janë adaptuar dhe rregulluar hyrjet ne objektin e QKMF konform nevojave dhe kërkesave të Personave me Aftësi të Kufizuara me qëllim të qasjes më të lehtë ne shërbimet shëndetësore. U raportua se kjo qendër i furnizon me karrige invalidore, paterica dhe mjete tjera ndihmëse për Personat me Aftësi të Kufizuara , (këto karrige dhe paterica janë donacion i bashkatdhetarëve tanë nga diaspora). U raportua se aktivitete dhe fushata vetëdijësuese për Personat me Aftësi të Kufizuara gjatë periudhës raportuese nuk janë mbajtur -QKMF në Lipjan ka raportuar se vizita mjekësore kane përfituar te gjithë pacientet të cilët kane kërkuar shërbime shëndetësore. Poashtu, është montuar ashensori për qasje më të lehtë në të gjitha shërbimet si dhe janë ndërtuar tualetet për Personat me Aftësi të Kufizuara . U raportua se po ashtu janë rregulluar të gjitha pjerrinat në institucionet e KPSH-së në Komunën e Lipjanit si dhe janë punësuar 15 infermier. Lidhur me këtë aktivitet u raportua se është ofruar shërbimi paliativ dhe vizitat në shtëpi për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Statusi i progresit: Implementuar
Buxheti total i planifikuar: 7500€

Aktiviteti I 1.2 *Vaksinimi i personave me aftësi të kufizuara me vaksinë të gripit sezonal*

Progresi i arritur: Vaksinimi i personave me aftësi të kufizuara gjatë viti 2023 është zhvilluar si në vijim:- QKMF – Podujevë ka raportuar se janë vaksinuar gjithsej 1 fëmijë, dhe 9 të rritur nga Personat me Aftësi të Kufizuara derisa në -QKMF – Viti janë vaksinuar gjithsej 23 Persona me Aftësi të Kufizuara -QKMF – Ferizaj janë vaksinuar gjithsej 54 Persona me Aftësi të Kufizuara -QKMF – Gjakovë ka raportuar se nuk ka evidencë **për numrin e te vaksinuarve të personave me aftësi të kufizuara**. Në QKMF – Fushë Kosovë janë vaksinuar 20 Persona me Aftësi të Kufizuara me vakcina kundër gripit sezonal derisa QKMF në Pejë ka raportuar se gjatë vitit 2023 janë vaksinuar gjithsej 293 Persona me Aftësi të Kufizuara . Sa i përket vaksinave kundër gripit sezonal raportohet se kryesisht **përfituesit kane qene nga OJQ** Dyart Olote Mëshire ,OJQ Qendra për jete te Pavarur, Hendikos SP Peje Pacientet ne Hemodialize dhe Shtëpia e pleqve DiKastro -Zahaq si dhe Shkolla e te verbërve Gjeladin Deda ne Pejë. Në -QKMF në Klinë janë vaksinuar gjithsej 29 Persona me Aftësi të Kufizuara derisa ky numër ne QKMF Obiliq për vitin 2023 ka qenë 15 -QKMF në Junik ka raportuar se gjatë viti 2023 është kryer edhe vaksinimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke mos specifikuar shifrat, gjersa raportohet se janë mbajtur 3 karavane shëndetësore për vetëdijesimin e qytetarëve për zbulimin e hershem te sëmundjeve kronike jo ngjitëse.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë.*

Aktiviteti I 1.3. *Hartimi i materialeve për promovim shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara dhe edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor*

Progresi i arritur: Lidhur me këtë aktivitet gjatë vitit 2023 numri i trajnimeve të organizuara për edukim shëndetësor dhe numri i materialeve edukative të shpërndara është zhvilluar si në vijim:-IKSHPK ka raportuar organizimin e fushatave kombëtare ndërgjegjësuere e zhvilluar dhe zbatuar -QKMF Viti ka raportuar mbi organizimin e një (1) trajnimi për edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor derisa -QKMF Ferizaj ka raportuar se është mbajtur një trajnim për edukim shëndetësor.-QKMF Gjakovë ka raportuar se bashkua me OJQ Hendikos ka mbajtur trajnime për edukime shëndetësore. Është raportuar se në bashkëpunim me AQH janë bërë video incizimet për promovim dhe edukim në hapësirat e pritjes për pacient-QKMF Mitrovicë raporton se janë shpërndara 500 materialeve edukative derisa -QKMF Pejë raporton se është mbajtur një (1) trajnim për edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor. Në bashkëpunim me AQH janë siguruar video incizimet për promovim dhe edukim në hapësirat e pritjes për pacient. Raportohet se janë shpërndara 500 materiale edukative gjate Karavaneve shëndetësore te organizuara nga AQH dhe Syri i vizionit -Pejë. Në Klinë është mbajtur një trajnim për edukim shëndetësor për punëtorët shëndetësor, derisa në Obiliq hartimi i materialit për promovim shëndetësor është bërë ne vazhdimësi shpërndarja nga IKSHPK ne bashkëpunim me AQH dhe QKMF. Sa i përket numrit te trajnimeve të organizuara për punëtorët shëndetësor për edukim shëndetësor gjate vitit 2023 janë trajnuar gjithsej 95 punëtor.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti total i planifikuar: *2500 €*

Aktiviteti I 1.4 Realizimi i shërbimeve shëndetësore ndaj Personat me Aftësi të Kufizuar

Progresi i arritur: Lidhur me këtë aktivitet MSH për vitin 2023 ka raportuar lidhur me rezultatet e publikuara nga pyetësorët e plotësuar nga Personat me Aftësi të Kufizuara për kënaqshmerinë ndaj shërbimeve shëndetësore si në vijim:-QKMF Podujeve është raportuar se nuk kanë ndonjë rezultat në këtë drejtim bazuar në formular, por duke besuar që kënaqshmëria është e mirë ngase ende nuk kanë pranuar ndonjë ankesë rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore derisa në Viti dhe Ferizaj plotësim të pyetësorëve vetëm për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk ka pasur por është bërë me të gjithë pacientët e rastit duke potencuar se shumica e përgjigjeve të tyre janë të kënaqshme-QKMF Gjakove ka raportuar se nuk është realizuar kënaqshmëria e shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara -QKMF në Pejë raporton se lidhur me rezultatet e publikuara nga pyetësorët e plotësuar nga Personat me Aftësi të Kufizuara për kënaqshmerinë ndaj shërbimeve shëndetësore raportohet se nuk kanë ndonjë rezultat në këtë drejtim bazuar në formular, duke besuar se kënaqshmëria është në nivel pasi nuk është pranuar asnjë ankesë. Gjatë vizitave të Koordinatorit të cilësisë janë plotësuar pyetësorët për kënaqshmëri por nuk është përpiluar raport i veçantë për Personat me Aftësi të Kufizuara -Në Klinikë dhe Obiliq poashtu nuk është bërë plotësimi i pyetësorëve vetëm për PA, por është bërë me të gjithë pacientët e rastit, ku shumica e përgjigjeve të pacienteve janë të kënaqshme.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Aktiviteti I 1.5. Trajnime për stafin infermierik dhe stafin mbështetës në tematikat e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar

Progresi i arritur: Lidhur me këtë aktivitet MSH për vitin 2023 ka raportuar lidhur me numrin e trajnimeve të realizuara ku përkritazi me infermierët e trajnuar kemi të dhënat si në vijim: QKMF Podujeve ka raportuar se nuk është ofruar asnjë mundësi e trajnimit të stafit në këtë drejtim, derisa në Gjakovë janë mbajtur katër (4) trajnime dhe punëtori të stafit të QKMF me stafin e Handikos-it. Nga QKMF Pejë është raportuar se nuk është ofruar asnjë mundësi e trajnimit të stafit në këtë drejtim, derisa në Obiliq në tematikat e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuar janë trajnuar 63 infermierë në 4 tema të tilla.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti i planifikuar: *10.000 €*

Aktiviteti 1.6. Koordinimi i aktiviteteve me MFPT

Progresi i arritur: Lidhur me koordinimin e aktiviteteve me MFPT, MSH ka raportuar si në vijim:- Në Podujevë aktiviteti *Motoja "le të ecim me këmbët e tyre"* –është organizuar në sheshin e qytetit si dhe takimi bashkëbisedues me Personat me Aftësi të Kufizuara i organizuar nga Handikos dhe Komuna për nder të ditës ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara -ve të mbajtur me datë 03.12.2023. Në Viti është mbajtur një trajnim për 19 infermierë derisa në Ferizaj janë trajnuar 40 infermierë. QKMF në Pejë ka raportuar se janë mbajtur takime, bashkëbisedime me Personat me Aftësi të Kufizuara të organizuara nga Handikos dhe Komuna për nder të ditës ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara derisa në Klinikë janë trajnuar 29 infermierë. Në Obiliq

u raportua se aktivitetet vazhdimisht harmonizohen me infermierë të DSHMS derisa në Lipjan gjatë vitit 2023 janë implementuar shërbimet e integruara ku përbëhen nga stafi mjekësor i QKMF-së dhe punëtorët e QPS-së, ku kryejnë vizita të përbashkëta.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Përkritazi me Objektivin specifik I'' *Ngritja e kapaciteteve të personelit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore''* në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë buxheti i përgjithshëm i ofruar për vitin 2023 i cili mbulon aktivitetet e analizuara më lartë për këtë objektiv është gjithsejtë 20,000.00 €.

Objektivi specifik II : Zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej kohës perinatale, natal edhe postnatale

Ky objektiv i cili përfshin 2 aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me 2.1. Realizimi i hulumtimeve në fushën e konditave shëndetësore që ndërlidhen me Personat me Aftësi të Kufizuara si dhe 2.2. Realizimi i programit për edukim shëndetësor për prindër në zbulimin të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar.

Treguesi 1: *Zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej kohës perinatale, natale dhe postnatale*

Treguesi 2: *Diagnostikimi perinatal me funksionimin e laboratorit*

Aktiviteti I.2.1 *Realizimi i hulumtimeve në fushën e konditave shëndetësore që ndërlidhen me Personat me Aftësi të Kufizuara*

Progresi i arritur: Hulumtimi për kënaqshmërinë ndaj shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara , është aprovuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës. Ka pasur pritshmëri që do realizohej në vitin 2023. Hulumtimi në fjale është në fazën e përpunimit të të dhënave dhe përpilimit të raportit final.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk është parapare buxhet*

Aktiviteti I.2.2 *Realizimi i programit për edukim shëndetësor për prindër në zbulimin të shkaktarëve që rezultojnë në aftësi të kufizuar.*

Progresi i arritur: Lidhur me këtë aktivitet janë realizuar veprimet si në vijim:

-QKMF Podujeve kanë raportuar se tashmë 1 vit kanë programin e vizitave shtëpiake për gratë shtatëzana dhe fëmijët 0 – 3 vjeç, program ky përmes së cilit përfshihet edhe edukimi shëndetësor për prindër në zbulimin e shkaktarëve që qojnë në aftësi të kufizuara.

-Programi i vizitave në shtëpi përkrahët nga UNICEF dhe nga ky program përfitojnë dhe Personat me Aftësi të Kufizuara -QKMF Ferizaj ka raportuar se gjatë muajit Maj 2023 janë mbajtur dy trajnime /ligjërata në lokalet e OJQ-së "HANDIKOS" dhe të Organizata Jofitimprurëse „HENDIFER". Në Gjakovë kanë raportuar se këtë rol e ushtron Këshillimorja për nëna dhe fëmijë dhe Këndet për promovim në edukimin shëndetësor; Në Mitrovicë janë mbajtur ligjërata për planifikim familjar, shëndet reproduktiv, kancer

të gjirit, PAP-test, shëndet oral, etj. Këto aktivitete janë mbajtur në hapësirat e Shoqatës së Hendikosit-Mitrovicë. Nga Peja dhe Klina u raportua se kanë programin e vizitave shtëpiake për gratë shtatëzana dhe fëmijët 0 – 3 vjeç program ky përmes së cilit përfshihet edhe edukimi shëndetësor për prindër në zbulimin e shkaktarëve që qojnë në aftësi të kufizuara. Në Obiliq mbi programin vizitave shtëpiake për gratë shtatëzana dhe fëmijët 0 – 3 vjeç program ky përmes së cilit përfshihet edhe edukimi shëndetësor për prindër në zbulimin e hershem të shkaktarëve që **qojnë në aftësi të kufizuara gjatë vitit 2023** janë realizuar gjithsej 481 vizita derisa në Lipjan nga viti 2016 aplikojnë programin e vizitave në shtëpi për nëna dhe fëmije deri në 3-vjeç, ku identifikohen edhe rastet e personave me Aftësi të Kufizuar. Në bashkëpunim me OJQ HANDIKOS-Lipjan dhe OJQ tjera të Personave me Aftësi të Kufizuar në komunën e Lipjanit, janë realizuar donacione nga Suedia me karroca dhe mjete ndihmëse për personat Personat me Aftësi të Kufizuar.

Për të forcuar kapacitetet e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe për të mundësuar zbatimin efektiv të shërbimeve të kujdesit për fëmijët pa kujdesin prindëror, gjatë periudhës raportuese është mbështetur zbatimi i programit ndërkombëtar të trajnimit-Moduli i Praktikës, në partneritet të ngushtë me OJQ SOS Children’s Villages.. Modeli i Krenarisë është një kurrikul i bazuar në kompetenca që trajnon dhe mbështet punonjësit socialë dhe familjet birësuese në ofrimin e shërbimeve familjare të sigurta dhe mbrojtëse për fëmijët pa kujdes prindëror dhe kanë nevojë për vendosje të qëndrueshme familjare. Përmes zbatimit të Modelit të Praktikës së Krenarisë, veprimi ka kontribuar në zhvillimin e standardeve kombëtare për promovim, trajnim, rekrutim dhe mirëmbajtje të shërbimeve të kujdestarisë në Kosovë.

Gjatë vitit 2023, ekspertët ndërkombëtarë Pride në mënyrë efektive kanë organizuar seanca të gjera trajnimi për shtatë profesionistë të mbrojtjes së fëmijëve. Këta profesionistë u zgjedhën posaçërisht nga Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes (DSPF) për t’iu nënshtruar trajnimeve. Shtatë trajnerët e masterit kombëtar kanë luajtur një rol vendimtar në shpërndarjen e ekspertizës për punonjësit socialë të CSË, duke fuqizuar familjet e kujdestarisë dhe për të rritur cilësinë e përgjithshme të shërbimeve të kujdestarisë. Brenda kornizës së metodologjisë së Krenarisë, e cila po aplikohet për herë të parë në Kosovë, Master Trainerët Kombëtarë (5 gra dhe 2 burra) kanë përfunduar me sukses trajnimin “Master Krenari” Prindërit dhe profesionistët e tjerë (16 gra dhe 6 burra) duke u mundësuar atyre të aplikojnë dhe shpërndajnë qasjen e Krenarisë në mënyrë efektive dhe të aftë në ofrimin e shërbimeve të kujdestarisë.⁷

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Ne kuadër të buxhetit të SHSKUK , KPSH dhe IKSHPK*

Në kuadër Objektivit Specifik II **Zbulimi i hershëm dhe identifikimi i aftësisë së kufizuar prej kohës perinatale, natal edhe postnatale** Ministrisë së Shëndetësisë nuk është alokuar buxhet për arsye se buxheti i planifikuar është paraparë në kuadër të buxhetit të SHSKUK , KPSH dhe IKSHPK.

7 “Protecting Vulnerable Children in Kosovo: Second Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023),” EU-funded project implemented by UNICEF.

Objektivi specifik III : Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Ky objektivi përfshinë gjithësejt 6 aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me 3.1. Hulumtimi i nevojave mbi plotësimin e listës esenciale të barnave, 3.2. Vazhdimi i ofrimit të ekzaminimeve (Mamografi dhe PAP test) për femrat me aftësi të kufizuar si dhe 3.3. Kujdesi për higjienën orale për fëmijët me aftësi të kufizuar. 3.4. Hartimi i PSO-ve për trajtim specifik shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuar, 3.5. Hartimi i qarkores informative për njoftimin e institucioneve shëndetësore me numrin e qendrës për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave si dhe 3.6. Realizimi i vizitave në komunitet për promovim dhe edukim shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Treguesi 1: *Njësi Spinale funksionale*

Treguesi 2: *Lista esenciale përmbush nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuar*

Aktiviteti I.3.1 *Hulumtimi i nevojave mbi plotësimin e listës esenciale të barnave.*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet për vitin 2023 komunat raportojnë se listat esenciale janë bazuar në nevojat e domosdoshme për Personat me Aftësi të Kufizuara sipas rezultateve të hulumtimit.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Aktiviteti I.3.2 *Vazhdimi i ofrimit të ekzaminimeve (Mamografi dhe PAP test) për femrat me aftësi të kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet QKMF Mitrovicë ka raportuar se janë bërë 3 mamografi për gra nga Personat me Aftësi të Kufizuara, derisa në Pejë gjatë muajit Tetor-Nëntor janë realizuar 105 ekzaminime ku 48 gra me Ca gjirit nga shoqata e tyre në Pejë kanë bërë ekzaminime falas.

-QKMF në Obiliq raportohet se nuk janë ofruar shërbime të monografisë apo PAP teste derisa në Lipjan u raportua se aksioni për parandalimin e kancerit të gjirit ka zgjatur gjatë muajit Tetor dhe Nëntor 2023 ku kanë përfutur edhe Personat me Aftësi të Kufizuara duke mos ofruar statistika specifike.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Aktiviteti I.3.3 *Kujdesi për higjienën orale për fëmijët me aftësi të kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: lidhur me numrin e ekzaminimeve të personave me aftësi të kufizuar (fëmijë) për higjienën orale në Mitrovicë 50 fëmijë ju janë nënshtruar kontrollit përkitazi me higjienën orale derisa nga QKMF Pejë u raportua se fëmijëve ju afrohen shërbime në QKMF dhe njësite e saja por po ashtu edhe në Poliklinikën e Stomatologjisë por nuk behet ndarja e pacienteve si Persona me Aftësi të Kufizuara.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Aktiviteti I.3.4 *Hartimi i PSO-ve për trajtim specifik shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: lidhur me këtë aktivitet është raportuar se gjatë vitit 2023 ka pasur Procedura Standarde Operative-te hartuara dhe te vëna në zbatim.⁸

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti total i planifikuar: *Nuk ka të dhëna mbi koston financiare*

Aktiviteti I.3.5 *Hartimi i qarkores informative për njoftimin e institucioneve shëndetësore me numrin e qendrës për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet është raportuar se Qarkorja Informative është aprovuar dhe është realizuar shpërndarja nëpër institucionet shëndetësore.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka të dhëna mbi buxhetin*

Aktiviteti I.3.6 *Realizimi i vizitave në Komunitet për promovim dhe edukim shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara*

Progresi i arritur: Lidhur me këtë aktivitet numri i vizitave të realizuara për Personat me Aftësi të Kufizuara një herë në vit të është zbatuar si në vijim:-QKMF Podujeve ka raportuar 3 vizita derisa në Viti janë realizuar dy aktivitete, në Ferizaj janë organizuar dy trajnime /ligjëratat me nga 30 pjesëmarrës për çdo ligjëratë. QKMF Mitrovicë ka raportuar 5 vizita gjatë vitit, sipas nevojës edhe më shpesh derisa në Pejë ka pasur aktivitete nga qendra e vaksinimit gjatë fushatës së informimit lidhur me vaksina të rregullta dhe vaksinat e reja sipas nevojës dhe më shpesh. Në Kline janë mbajtur dy trajnime në komunitete për edukim shëndetësor për Personat me Aftësi të Kufizuara derisa në Obiliq janë organizuar vizitat sistematike në shkollat fillore të mesme të ulte ku janë përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara .

Gjatë vitit 2023, 1.447 fëmijë me aftësi të kufizuara (630 vajza dhe 817 djem) kanë përfutur nga shërbimet e rehabilitimit, duke përfshirë terapinë e të folurit, fizioterapinë, terapinë psikosociale ose pajisjet ndihmëse të ofruara nga DSK, Handikos HQ, Handikos Gjakova CBR Qendrat dhe Shoqata e Prindërve Podrzi. Njëkohësisht, 1.339 prindër dhe kujdestarë të fëmijëve me aftësi të kufizuara (855 gra dhe 484 burra) kanë marrë pjesë në seanca të specializuara trajnime, duke i pajisur ata për të mbështetur fazat e zhvillimit dhe nevojat specifike të fëmijëve të tyre në ndërveprimet e tyre të përditshme.⁹

UNICEF, në bashkëpunim me Sindromën Down Kosova, Handikos, URPM dhe Handikos Gjakova, Forcimi i Vazhdueshëm i Shërbimeve të Rehabilitimit të Bazuar në Komunitet Efektiv dhe të Qëndrueshëm Me aftësi të kufizuara në 25 komuna organizuan ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta në 13 qendra të rehabilitimit të bazuar në komunitet (CBR) në Pristina, Gjilan, Peja, Ferizaj, Mitrovica Jugore, Mitrovica Veriore, Drenas, Prizren dhe Gjakova. Në partneritet me Sindromën Down Kosova (DSK), programi prezantoi një qasje të re duke ofruar shërbime të përziera-si në shtëpi ashtu edhe në

8 Për më shumë: <https://msh.rks-gov.net/Documents/Index/1287>

9 "Protecting Vulnerable Children in Kosovo: Second Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023)," EU-funded project implemented by UNICEF.

distancë-në 25 komuna. Gjatë periudhës së raportimit. DSK lehtësoi seancat e vlerësimit dhe rivlerësimit për 560 fëmijë dhe adoleshentë me aftësi të kufizuara (229 vajza dhe 331 djem), duke siguruar seanca të terapisë së përshtatur bazuar në planet individuale të ndërhyrjes që përfshijnë fizioterapinë, terapinë e të folurit dhe terapinë e zhvillimit profesional. Këto shërbime u ofruan përmes DSK CBRS në Pristina, Prizren, Mitrovicë Jugore, Ferizaj dhe Gjilan, të cilët zgjeruan shërbimet e tyre në internet për 20 komuna të reja.¹⁰

Janë siguruar gjithsej 8,357 seanca terapeutike individuale dhe 11.910 grupore, së bashku me 1.000 takime në internet me prindërit dhe kujdestarët për të monitoruar përparimin e terapive në shtëpi dhe për të adresuar çdo sfidë të hasur gjatë zbatimit. Për më tepër, gjatë kësaj periudhe, gjithsej 558 prindër/kujdestarë (355 gra dhe 203 burra) iu nënshtruan ushtrimeve për krijimin e kapaciteteve për të marrë pjesë më mirë në kërkesat e zhvillimit të fëmijëve të tyre.¹¹


Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: 7500 €

Buxheti i përgjithshëm për objektiven specifike 3 “Rritja e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara ” në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023 i cili mbulon aktivitetet e parapara për këtë objektiv është shuma totale prej 7500.00 €.

Përkritazi e Objektiven strategjike 1 “Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara” buxheti total i alokuar për vitin 2023 është 27,500.00 €.

Realizimi i objektivave nga fusha e shëndetësisë për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2023

Nga gjitha aktivitetet e zhvilluara për vitin 2023 nga fusha e shëndetësisë për Personat me Aftësi të Kufizuara , diagrami i mëposhtëm paraqet përqindjen e aktiviteteteve si në vijim:



Diagrami lidhur me përqindjen e aktiviteteteve nga fusha e shëndetësisë për Personat me Aftësi të Kufizuara

10 “Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19”: Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

11 Po aty.

2. MIRËQENJA SOCIALE DHE PUNËSIMI

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 2: SISTEM FUNKSIONAL DHE I MIRËFILLT PËR MIRËQENIEN DHE SIGURINË SOCIALE SI DHE OFRIMI I MUNDËSIVE TË BARABARTA PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar përcakton obligimet e shteteve palë mbi njohjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar për një standard adekuat jetese, përfshirë ushqimin, veshjen, strehimin, punësimin si dhe sigurimin e pensionit, të cilat përbëjnë një standard dhe obligim ndërkombëtarë. Me këtë parim objektiva strategjike vë në pah që mbrojtja sociale të mbështet të gjithë personat në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

Objektivi Specifik 1: Shtrirja e shërbimeve në komunitet - Ky objektivi përfshinë 13 aktivitete që janë: 1.1 Implementimi i Skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuar, të moshës 18-65 vjeç. 1.1.1. Zbatimi i Ligji 03/L-022 për Përkrahje Materiale për Familje me Aftësi të Kufizuara të Përhershme, 1.2 Implementimi i Skemës për Kompensimin e Personave të Verbër, 1.3. Implementimi i Skemës për; Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, 1.5 Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar, 1.6 Trajnimi i Komisionit Bio- Psiko-Social për përdorime e instrumentit të KNF-s, 1.7. Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve sociale në shtëpitë me bazë në komunitet për fëmijë dhe të rriturit me aftësi të kufizuara intelektuale (mendore-ngecje në zhvillimin mendor), 1.8. Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve në qendrat rezidenciale (ISSH), 1.9 Licencimi individual dhe i OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara, 1.10. Ofrimi i shërbimeve nga Organizatat për Personat me Aftësi të Kufizuara të licencuara. 1.10.1 Krijimi i një fondi të veçantë për mbështetje financiare OJQ-ve të licencuara që ofrojnë shërbime për persona me aftësi të kufizuar, 1.10.2 Fuqizimi i mekanizmit monitorues dhe inspektues për shërbimet dhe fondet e organizatave përfituese, 1.11. Përcaktimi i kodit buxhetor për shërbimet sociale.

Objektivi specifik I: Shtrirja e shërbimeve në komunitet

Treguesi 1: *Shërbime kualitative në qendrat rezidenciale*

Treguesi 2: *Shërbime sociale në nivel komunal nga shoqatat e kontraktuara*

Aktiviteti I 1.1 *Implementimi i Skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuar, të moshës 18-65 vjeç*

Përshkrimi i të arriturave: Sipas raportit të pranuar nga MFPT, numri i përfituesve i skemës pensionale për personat me aftësi të kufizuar të moshës 18-65 vjeç në vitin 2023 ka qenë: 20.616 ndërsa vlera e buxhetit të shpenzuar 26,847,509.00€. Në fazën e vitit 2021-2023 janë dhënë fonde shtesë për shkak të skemave për mbështetje të Personave me Aftësi të Kufizuara si rrjedhojë e pandemisë dhe për këtë arsye vlera e buxhetit të shpenzuar është më e lartë se buxheti i planifikuar.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: *17,650.000.00*

Aktiviteti I.1.2 Zbatimi i skemave te përfitimeve dhe kompensimeve

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet është raportuar se është ofruar mbështetje me pagesa, përmes skemave pensionale dhe kompensimeve.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 67.000 €.

Aktiviteti I.1.3 Zbatimi i Ligji 03/L-022 për përkrahje materiale për familje me aftësi të kufizuara të përhershme

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet dhe bazuar në Ligjin nr.03 L -022 për Përkrahje Materiale Familjeve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuara të Përhershme prej 0-18 vjeç, MFPT ka raportuar se për muajin prill 2023 kanë përfituar 344 familje me fëmijë me aftësi të kufizuara. Raportohet se numri i përfituesve sipas pagesave mujore, (muaji maj), total i fëmijëve me aftësi të kufizuara është 3425, derisa shuma totale e pagesave është 343,500.00.

Nr.i muajve	Numri	Retro	Totali
1 muaj	3423	€ 100.00	€ 342,300.00
4 muaj	1	€ 400.00	€ 400.00
8 muaj	1	€ 800.00	€ 800.00
	3425	Totali	€ 343,500.00

Tabela 1: Lista e pagesës së numrit të përfituesve sipas pagesave mujore dhe familjet/rastet që kanë përfituar në mënyrë retroaktive sipas raportimeve nga MFPT

Gjatë periudhës raportuese 73 fëmijë (38 vajza dhe 35 djem) nga të cilët nëntë fëmijë me aftësi të kufizuara ishin vendosur në familje kujdestare në 17 komuna; Tre familje të reja të kujdesit kujdestar janë rekrutuar dhe nëntë familje kujdestare janë në pritje të rekrutimit zyrtar. 243 profesionistë (afërsisht 65% gra dhe 35% burra), përfshirë përfaqësues nga drejtori komunale të shëndetit dhe mirëqenies sociale, CSË, Departamenti i Politikave për Shërbimin Social dhe Familjar, arsimtarët e shkollës, mësuesit dhe punonjësit e shëndetit kanë përfituar nga punëtori, trajnime, takime kryer në periudhën e raportimit. Si rezultat i avokimit të vazhdueshëm të UNICEF dhe OSHC -ve dhe ndihmës teknike, në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, e Ministria e Drejtësisë njoftoi rritjen e pagesës së kujdestarisë për 40 përqind në pagesa mujore për fëmijët në kujdestari, duke përfituar 485 fëmijë.¹²

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 343,500,00.00€

12 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

Aktiviteti I.1.4 *Implementimi i Skemës për: Kompensimin e Personave të Verbër.*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet u raportua se numri i përfituesve nga Skema për Kompensimin e Personave të Verbër ka qenë 1893 dhe vlera e buxhetit të shpenzuar 5,132,647.00□

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: *5,252,000.00*

Aktiviteti I.1.5 *Implementimi i Skemës për Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.*

Përshkrimi i të arriturave: Gjatë vitit 2023 numri i përfituesve i Skemës për Kompensimin e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik ka qenë 3006 dhe vlera e buxhetit të shpenzuar 11,474,669.00□.

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: *10,176,380.00 €*

Aktiviteti I.1.6 *Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar.*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet nga MFPT kanë raportuar se aktet nënligjore nuk janë draftuar përderisa Projektligji për personat me aftësi të kufizuar nuk është finalizuar.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*
Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

Aktiviteti I.1.7 *Trajnimi i Komisionit Bio-Psiko-Social për përdorime e instrumentit të KNF-se*

Përshkrimi i të arriturave: Sipas raportimit të MFPT ky trajnim nuk është mbajtur në vitin 2023, megjithatë nën partneritetin e UNICEF dhe organizatës së tij partnere OJQ për fëmijë pa kujdes prindëror (OFAP), 73 fëmijë në kujdestari (35 djem dhe 38 vajza) dhe 69 fëmijë të vendosur në Kinship Care (30 djem dhe 39 vajza) përfituan nga shërbime të vazhdueshme psikosociale. Seancat e prindërimit u mbajtën gjithashtu me familje dhe 29 familje kujdestare, dhe 24 familje për kujdesin farefisnor përfituan nga seanca të vazhdueshme të prindërve të ofruara për edukimin, shëndetin dhe mirëqenien sociale të fëmijëve. Për më tepër, 39 familje kujdestare (27 familje aktive të kujdestarisë së kujdestarisë, 5 familje kujdestare dhe 7 nëna të kujdestarisë SOS) kanë përfunduar programin e trajnimit për ofrimin e shërbimeve të specializuara të kujdesit kujdestar.¹³

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

13 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

Aktiviteti I.1.8 *Vazhdimi i ofrimit të shërbimeve në qendrat rezidenciale (ISSH)*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet Ministria e Drejtësisë ka raportuar se gjatë vitit 2023 Instituti Special në Shtime dhe nëntë (9) shtëpi me bazë në komunitet kanë trajtuar Personat me Aftësi të Kufizuar (ngecje mendore) pa kujdes familjar. Nga muaji janar 2023, Instituti Special në Shtime dhe Shtëpia e Fëmijëve në Shtime kanë kaluar në menaxhim të Ministrisë së Shëndetësisë ku Marrëveshja e bashkëpunimit mes MFPT-s dhe MSH-s përcakton detyrat dhe obligimet ligjore.

Me qëllim të forcimit të ofrimit të shërbimeve sociale cilësore, UNICEF në partneritet me KOMF dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, mbështeti hartimin dhe botimin e analizës mbi raportin aktual të gjendjes aktuale të Qendrave për Puna Sociale. Qëllimi i analizës ishte identifikimi i boshllëqeve dhe sfidave në ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe ofrimi i rekomandimeve konkrete për reformën e CSË. Për më tepër, ekspertiza teknike u dha për të zbatuar ligjin për shërbimet sociale dhe familjare i cili është aprovuar nga Asambleja e Kosovës.¹⁴ Për të mbështetur forcimin e fuqisë punëtore të shërbimeve sociale, janë zhvilluar nëntë module trajnimi. Si pjesë e këtij projekti, janë trajnuar rreth 312 ofrues të shërbimeve sociale, përfshirë 145 punonjës socialë në CSË. Për më tepër, për të forcuar kapacitetet e zyrtarëve lokale në financimin e shërbimeve sociale, rreth 170 zyrtarë nga drejtori komunale janë trajnuar për planifikimin, monitorimin, buxhetimin, koston dhe kontraktimin të shërbimeve sociale. Për më tepër, 430 punëtorë të mbrojtjes së fëmijëve në 28 komuna janë trajnuar për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Për të forcuar kapacitetet e profesionistëve të mbrojtjes së fëmijëve dhe për të mundësuar zbatimin efektiv të kujdesit për shërbimet e kujdestarisë për fëmijët pa kujdes prindëror, projekti ka mbështetur Departamentin e Politikave për Shërbime Sociale dhe Familjare (DPSF), në Ministrinë e Drejtësisë, për të përpiluar udhëzimin për monitorimin, vlerësimin dhe inspektimin e Qendrës për Punën Sociale (CSË) për zbatimin e shërbimeve të kujdesit të kujdestarisë. Pas miratimit të udhëzimit nga DPSFS në qershor 2023, 23 përfaqësues nga drejtorët komunalë të shëndetit dhe mirëqenies sociale dhe CSW nga 12 komuna kanë avancuar njohuritë e tyre mbi këto procedura. Në bashkëpunim të ngushtë me DPSP -të, 79 punonjës socialë të CSË nga 20 komuna u trajnuan dhe kanë ngritur njohuritë dhe kapacitetet e tyre për ofrimin e shërbimeve të kujdesit kujdestar. Poashtu, u organizuan punëtori trajnimi katër-ditore dhe rreth 100 profesionistë të mbrojtjes së fëmijëve në 28 komuna u trajnuan për zbatimin e manualit të programit të kujdestarisë dhe birësimit të zhvilluar me mbështetjen e UNICEF dhe të miratuara nga DPSFS . Për më tepër, 65 profesionistë të mirëqenies sociale dhe 13 familje kujdestare nga komunat e rajonit të Mitrovicës Veriore fituan njohuri të avancuara më tej mbi sigurimin e specializuar të kujdestarisë.¹⁵

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *1,100,000.00 Euro*

14 Po aty.

15 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

Aktiviteti I.1.9 *Licencimi individual dhe i OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar .*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet u raportua se nga Janari 2023 licencimi i OJQ-ve ka kaluar në kompetencë të Ministrinë e Drejtësisë. Raportohet se janë te licencuara 38 OJQ qe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për personat me aftësi të kufizuar si dhe 3 SHPK.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk është raportuar për ndonjë kosto financiare*

Aktiviteti I.1.10 *Fuqizimi i mekanizmit monitorues dhe inspektues për shërbimet dhe fondet e organizatave përfituese*

Përshkrimi i të arriturave: Gjate vitit 2023, OJQ-të përfituese sipas thirrjes publike nga Ministrisë së Drejtësisë janë monitoruar nga ekipi për monitorim. Njësi për inspektim pranë MD po ashtu ka inspektuar dy (2) OJQ dhe një (1) institucion publik komunal duke potencuar se zyrtarët e MD-së kryejnë procesin e vazhdueshëm të monitorimit.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik II.1: **Shtrirja e shërbimeve në komunitet është 37,845.380.00 Euro**

Objektivi Specifik 2- KRIJIMI I KUSHTEVE TË BARABARTA PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Objektivi specifik 2- Përfshinë krijimin e kushteve të barabarta për Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar -Objektiv i cili parashihet te ketë 5 aktivitetet e që janë: 2.1.Ofrimi i Shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuar në Shërbime të Karrierës, 2.2. Fuqizimi i inspektoratit te punës për monitorimin e zbatimit te Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim, 2.3.Ndërmjetësimi i Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim, 2.4.Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim përmes masave aktive të tregut të Punës, 2.5. Fushatat vetëdijësuese për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar ë sektorin publik dhe privat.

Treguesi 1: *Zbatimi i Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin dhe Punësimin e personave me Aftësi të Kufizuar*

Aktiviteti I.2.1 *Ofrimi i Shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuar në Shërbime të Karrierës*

Përshkrimi i të arriturave: Numri i Personave me Aftësi të Kufizuar që kane marr shërbime në karriere gjate vitit 2023 ishte: 212 persona, ku prej tyre gra ishin 43 dhe burra 169.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *200.000€*

Aktiviteti I.2.2 Fuqizimi i inspektoratit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me zbatimin e këtij aktiviteti, MFPT raporton se ky objektivi është realizuar sa i përket fuqizimit të inspektoratit të punës për monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr.03/019 për Aftësim, Riaftësim dhe Punësim

Statusi i progresit: *Implementuar*
Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Aktiviteti I.2.3 Ndërmjetësimi i Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim

Përshkrimi i të arriturave: Sipas raportimeve të pranura nga APRK, gjatë viti 2023 është realizuar ndërmjetësimi në punësim të rregullt të Personave me Aftësi të Kufizuar për 5 persona ku prej tyre ka qenë 1 grua.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti i planifikuar: *300,000.00 €*

Aktiviteti I.2.4 Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim përmes Masave Aktive të Tregut të Punës

Përshkrimi i të arriturave: Sipas raportimit të APRK -së numri i Personave me Aftësi të Kufizuar të përfshirë në masat aktive të tregut të punës gjatë vitit 2023 ishin 10 persona, ku prej tyre katër (4) dhe gjashtë (6) burra.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*
Buxheti i planifikuar: *500,000.00 €*

Fusha 4 - Barazia në Punësim, Shërbime Sociale dhe Familjare

Kjo fushë prej dy rezultateve dhe katër treguesve mbulon përfaqësimin e grupeve të ndryshme në punësimin komunal, si dhe shërbimet sociale të grupeve më me nevojë në komuna. Në kuadër të punësimit treguesit matin nivelin e punësimit të personave me aftësi të veçanta në institucionet komunale, si dhe përqindjen e përfshirjes së komuniteteve jo shumicë. Performanca e përgjithshme në këtë fushë prej 60.30%.




Tabela 2. Krahasimi i performancës së komunave në fushën barazia në punësim, shërbime sociale dhe familjare sipas raportimeve nga MFPT




Tabela 3 : Treguesit e performancës në fushën e barazisë në punësim, shërbime sociale dhe familjare bazuar në gjendjen e paraqitur nga MFPT

Siç është raportuar nga MFPT niveli i përmbushjes së kuotës për të punësuar me nevoja të veçanta mbetet i ulët, referuar kriterit të përcaktuar në Ligjin Nr. 05L-051 për mbrojtje nga diskriminimi. Sipër, janë pasqyruar të arriturat për secilën komunë në kuadër të kësaj fushe: Përqindje më e lartë është shënuar në dy tregues: Familje në nevojë të cilave iu është siguruar banimi social, në masën 69.13% dhe fëmijë në nevojë që iu është siguruar strehimi familjarë, në përqindjen prej 90.99%.

Aktiviteti I.2.5 Fushatat vetëdijësuese për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar në sektorin publik dhe privat.

Përshkrimi i të arriturave: Përkitazi me këtë aktivitet u raportua se është mbajtur panairi Kombëtare i Punës, ku janë pasqyruar edhe shërbimet që ofrohen nga ZP dhe QAP për Personat me Aftësi të Kufizuar , po ashtu janë bere edhe disa video promovuese për shërbimet që i ofron APRK.¹⁶

Statusi i progresit: Në proces të zbatimit
Buxheti i planifikuar: 100,000.00 €

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik II.2 Krijimi kushteve të barabarta për punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuar është 1,100.000.00 Euro.

16 <https://www.facebook.com/share/v/oZrLhPPU1ZpZXjmb/?mibextid=oFDknk>

Objektivi specifik III: AFTËSIMI DHE RIAFTËSIMI PROFESIONAL PËR PËRGATITJEN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR TREGUN PUNËS

Objektivi specifik 3 - Aftësimi dhe riaftësimi profesional për përgatitjen e Personave me Aftësi të Kufizuara për Tregun e punës - objektivi i cili parashihet t'i ketë 5 aktivitete 3.1 Zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës, 3.2. Trajnimi i Personave me Aftësi të Kufizuar në Qendrat e Aftësimit Profesional, 3.3. Kurrikulat e adaptuara për Personat me Aftësi të Kufizuar , 3.4. Adaptimi i punëtorëve me pajisje për nevojat e personave me aftësi të kufizuar, 3.5. Trajnimi i trajnerëve të QAP për implementimin e kurrikulës së adaptuar për Personat me Aftësi të Kufizuar .

Treguesi 1: *Përqindja e PAK të trajnuar në Qendrat e Aftësimit Profesional*

Treguesi 2: *Kabinetet e trajnimit të gatshme për Implementimin e Kurrikules të adaptuar për Personat me Aftësi të Kufizuar*

Aktiviteti I.3.1 *Zgjerimi i profileve për aftësim dhe riaftësim profesional sipas kërkesave të tregut të punës.*

Përshkrimi i të arriturave: Gjate vitit 2023 janë zgjeruar dhe ri-funksionalizuar profilet në: Rrobaqepësi, furrtari, parukeri dhe instalime elektrike QAP-Prishtinë, rrobaqepësi, instalime elektrike dhe kuzhinë në Gjakovë, ndërtimtari, furrtari dhe rrobaqepësi në QAP-Prizren, kuzhinë në QAP-Gjilan, parukeri/grimere dhe instalime elektrike në Mitrovicë si dhe zdrukthëtari në QAP-Ferizaj ku në total janë realizuar 14 profile të ri-funksionalizuara/zgjeruara. Pra këto profile përdoren edhe nga personat me aftësi kufizuar.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë buxhetore*

Aktiviteti I.3.2 *Trajnimi i Personave me Aftësi të Kufizuar në Qendrat e Aftësimit Profesional*

Përshkrimi i të arriturave: Si u raportua nga APRK, gjate vitit 2023 nga rradhët e Personave me Aftësi të Kufizuar në aftësim profesional janë inkuadruar 60 persona.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë buxhetore*

Aktiviteti I.3.3 *Kurrikulat e adaptuara për personat me aftësi të kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: Gjate vitit 2023 janë rishikuar/finalizuar kurrikulat mësimore duke u bazuar në standardet e profesionit në kualifikimet: nëpunës i kontabilitet, murator, zdrukthëtari dhe instalime elektrike. Këto kurrikula përdoren edhe nga personat me aftësi të kufizuar.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë buxhetore*

Aktiviteti I.3.4. *Adaptimi i punëtorive me pajisje për nevojat e personave me aftësi të kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: Me financim të buxhetit të Republikës së Kosovës është bërë furnizimi me pajisje/vegla pune më të avancuara për 5 Qendrat e Aftësisimit Profesional ku të njëjtat pajisje përdoren edhe nga Personat me Aftësi të Kufizuar .

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *25,000.00 €*

Aktiviteti I.3.5 *Trajnimi i trajnerëve të QAP për implementimin e kurrikules së adaptuar për Personat me Aftësi të Kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: MFPT ka raportuar se në vitin 2023, janë trajnuar nga donatorët 20 trajner të përgatitur për implementim të Kurrikulës dhe qasjes ndaj Personave me Aftësi të Kufizuar

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Buxheti për këtë aktivitet ka qenë 6,000.00 € i alokuar nga donatorë*


Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.3 Aftësimi dhe Riaftësimi Profesional për Përgatitjen e Personave me Aftësi të Kufizuara për Tregun e Punës për vitin 2023 është 31,000.00 Euro.

Ndërkaq, buxheti i përgjithshëm për Objektivin Strategjike 2: Sistem funksional dhe i mirëfillte për mirëqenien dhe sigurinë sociale si dhe ofrimi i mundësive të barabarta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara për vitin 2023 është 38,976.380.00 Euro.

Realizimi i objektivave nga fusha e mirëqenies sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar për vitin 2023

Nga gjitha aktivitetet e zhvilluara për vitin 2023 nga fusha e mirëqenies sociale dhe punësimit për Personat me Aftësi të Kufizuar diagrami i mëposhtëm paraqet përqindjen e aktiviteteteve si në vijim:

Statusi i aktiviteteteve nga fusha e mirëqenies sociale dhe punësimit



Grafiku i aktiviteteteve nga fusha e mirëqenjes sociale dhe punësimit

ARSIMI

OBJEKTIVA STRATEGJIKE 3: KRIJIMI I KUSHTEVE PËR GJITHË PËRFSHIRJEN NË ARSIM DHE PËR MBËSHTETJEN PROFESIONALE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Duke ju referuar Strategjisë nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023, E drejta për edukim është e drejtë elementare e çdo njeriu. Që kjo e drejtë të realizohet pa diskriminim dhe në bazë të mundësive të barabarta, shteti duhet të sigurojë një sistem edukimi gjithë përfshirës në të gjitha nivelet dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara për të realizuar këtë të drejtë, shteti duhet të sigurojë se Personat me Aftësi të Kufizuara nuk janë përjashtuar nga sistemi i edukimit të përgjithshëm për shkak të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk janë përjashtuar nga arsimimi pa pagesë dhe i detyruar fillor, ose arsimi i mesëm. Është obligim shtetëror që personave me aftësi të kufizuara të ju mundësoj aftësimin për zhvillim të potencialit të tyre për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në edukim.

Duke ditur obligimet e njohura ndërkombëtarisht tanimë Republika e Kosovës ka filluar të marrë masat e duhura që mundësojnë jetësimin e këtyre kritereve, filluar me mësimin sipas planit individual të arsimit (PIA), identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, arsimin profesional, të mësuarit gjatë gjithë jetës, trajnime adekuate dhe mbështetjen për profesionistët që punojnë në të gjitha nivelet e arsimit me nxënësit me aftësi të kufizuara. Me zbatimin e kësaj objektivë strategjike Republika e Kosovës do të përmbushë të gjitha nevojat e Personave me Aftësi të Kufizuara për një edukim adekuat.

Objektivi Specifik 1: KRIJIMI I MEKANIZMAVE PËR IDENTIFIKIMIN DHE EDUKIMIN E HERSHEM TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Objektivi Specifik 1: Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe edukimin e hershem të fëmijëve me aftësi të kufizuara përfshinë 5 aktivitete si në vijim: 1.1.Hartimi i 3 udhëzuesve edukatorët për qasjen dhe punën me fëmijët me aftësi të kufizuara, 1.2.Ngritja e kapaciteteve të edukatoreve për zbatim të udhëzuesve, 1.3.Hartimi dhe ofrimi i materialeve pedagogjike në 2 platformat e MASH –it, 1.4 Fushatë vetëdijesuese për rëndësinë e intervenimit të hershem për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Treguesi 1: *Baza e të dhënave të integruara të fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla*

Treguesi 2: *Vlersimi i nevojave të përgjithshme për staf mbështetës për fëmijë me aftësi të kufizuara*

Treguesi 3: *Formula funksionale për financimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara*

Treguesi: *Edukatorët e trajnuar për secilën grupmoshë në IP*

Aktiviteti I.1.1 Hartimi i 3 udhëzuesve edukatorët për qasjen dhe punën me fëmijët me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i të arriturave: për vitin 2023 MASHTI ka raportuar se udhëzuesit nuk janë hartuar meqenëse donatori e ka larguar objektiven e edukimit në fëmijërinë e hershme me këtë edhe nuk kanë arritur të trajnohen as edukatorët.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

Aktiviteti I.1.2 Ngritja e kapaciteteve të edukatoreve për zbatim të udhëzuesve

Përshkrimi i të arriturave: Pasi udhëzuesit nuk janë hartuar edhe trajnimi i edukatoreve nuk ka ndodhur. MASHTI raporton se ky veprim ka qenë i bazuar tek donatorët andaj nuk është realizuar.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk është paraparë buxhet pasi që ka qenë projekt i donatoreve.*

Aktiviteti I.1.3 Hartimi dhe ofrimi i materialeve pedagogjike në 2 platformat e MASH –it

Përshkrimi i të arriturave: lidhur me këtë aktivitet për vitin 2023 MASHTI raporton se platformat kanë qenë aktive dhe janë mbështetur nga Save the Children duke potencuar se këto platforma kanë funksionuar shkëlqyeshëm në kohën e pandemisë e me pastaj nuk ka pasur ndonjë mbështetje.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

Aktiviteti I.1.4 Fushatë vetëdijesuese për rëndësinë e intervenimit të hershëm për fëmijët me aftësi të kufizuara

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet nga MASHT-i për vitin 2023 u raportua se edhe kjo fushatë është anuluar në mungesë të donatoreve

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk është paraparë ndonjë shumë e caktuar financiare*

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.1 Krijimi i mekanizmave për identifikimin dhe edukimin e hershëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara përgjatë viti 2023 ka qenë i planifikuar 5,000.00€.

OBJEKTIVI SPECIFIK: KRIJIMI, FUQIZIMI DHE PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE TË MEKANIZMAVE NDËR-SEKTORIAL DHE MEKANIZMAVE TJERË MBËSHETËS PËR SHKOLLËN GJITHËPËRFSHIRËSE

Objektivi Specifik 2: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmave ndër-sektorial dhe mekanizmave tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse

Përfshinë 5 aktivitete të cilat janë: 2.1.Punësimi /apo sigurimi i mësuesve mbështetës në shkolla, 2.2.Punësimi i asistentëve mbështetës në shkolla, 2.3.Ngritja e kapaciteteve të ekipeve vlerësuese për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja, 2.3.1 Ofrimi i shërbimeve në Braille, orientim dhe mobilitet për fëmijët e verbër në shkollë të rregullta, 2.4.Ngritja e kapaciteteve të mësimeve të përditshme për çasjen dhe punën me nxënësit me aftësi të kufizuara

Treguesi 1: *Numri i fëmijëve në aftësi të kufizuar që marrin shërbime nga Qendrat Burimore në shkollë*

Treguesi: *Ekipe funksionale në çdo komunë për vlerësim pedagogjik*

Aktiviteti I.2.1 Punësimi /apo sigurimi i mësuesve mbështetës në shkollë

Përshkrimi i të arriturave: Është raportuar nga MASHTI se 69 mësues mbështetës janë të alokuar në shkollë të rregullta për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Kosto e shpenzimeve varet nga komunat*

Aktiviteti I.2.2 Punësimi i asistentëve mbështetës në shkollë

Përshkrimi i të arriturave: Përkitazi me punësimin e asistentëve mbështetës raportohet se aktualisht janë punësuar 339 asistent/e në lëmin e sistemit arsimor.

Për të përmirësuar hyrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim, siq ka raportuar UNICEF-i për vitin 2023 është mbështetur angazhimi i 25 asistentëve të mësuesve në pesë komuna në institucionet e arsimit parashkollor, fillor dhe të ulët të arsimit. Si rezultat, gjatë periudhës së raportimit, mbi 75 fëmijë me aftësi të kufizuara (44 djem; 27 vajza) përfituan nga mbështetja e përditshme e ofruar përmes asistentëve të angazhuar të mësuesve. Në mënyrë të ngjashme, u bën përpjekje për avokim për të synuar komunat që të përfshijnë këta asistentë të mësuesve në listën e pagave të rregullta të stafit. Punëtori avokimi u organizuan me komunat e Gjilan dhe Gjakova për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e angazhimit të asistentëve të mësuesve për të përmirësuar çasjen në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara.¹⁷

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *787,662.00 €*

17 "Protecting Vulnerable Children in Kosovo: Second Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023)," EU-funded project implemented by UNICEF.

Aktiviteti I.2.3 *Ngritja e kapaciteteve të ekipeve vlerësuese për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MASHTI raporton se gjatë viti 2023, gjithsejtë janë trajnuar 215 anëtar të ekipeve vlerësuese.

Sipas raportit të UNICEF-it për vitin 2023 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) Projekt i USAI-it i implementuar nga UNICEF-i, për të rritur ekzaminimin për fëmijët me vështirësi funksionale, Handikos Gjakova, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit Komunal, pilotoi për herë të parë pyetësorin e Grupit të Uashingtonit. Mbi 2.300 fëmijë të regjistruar në parashkollorë dhe klasat e 2 -të dhe të 4 -të të arsimit fillor u ekzaminuan, me raportet që do të përdoren për të propozuar një model për të gjithë sistemin arsimor. Për më tepër, 159 prindër/kujdestarë (102 gra, 57 burra) morën mbështetje për të rritur aftësitë e tyre në promovimin e zhvillimit dhe pavarësisë së fëmijëve të tyre.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 5.000.00 €

Aktiviteti I.2.4 *Ofrimi i shërbimeve në Braille, orientim dhe mobilitet për fëmijët e verbër në shkolla të rregullta*

Përshkrimi i të arriturave: Për vitin 2023 u raportua se është bërë akreditimi i programit dhe unifikimi i shkrimit brail ku kanë përfituar 90 nxënës në shkolla të rregullta (tri grupe nga 30 pjesëmarrës)

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 10.000 €

Aktiviteti I.2.5 *Ngritja e kapaciteteve të mësimitdhënësve për qasjen dhe punën me nxënësit me aftësi të kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MASHTI ka raportuar se për tre vite janë trajnuar 5000 mësimitdhënës nga projekti INCUDE lidhur me qasjen dhe punën me nxënësit me aftësi të kufizuara.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 8,000.00€

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.2: Krijimi, fuqizimi dhe përmirësimi i shërbimeve të mekanizmave ndër-sektorial dhe mekanizmave tjerë mbështetës për shkollën gjithëpërfshirëse për vitin 2023 është 810,662.00 €.

I.3. OBJEKTIVI SPECIFIK: TË KRIJOHET NJË MJEDIS I PËRSHTATSHËM PËR GJITHË PËRFSHIRJE NE SHKOLLË DHE KOMUNITET

Objektivi Specifik 3: Të krijohet një mjedis i përshtatshëm për gjithë përfshirje ne shkollë dhe komunitet ku përfshinë 8 aktivitetet si në vijim: 3.1.Hartimi i planit 5 vjeçar për qendrat burimore, 3.2.Rritja e shërbimeve nga qendrat burimore për shkollat e rregullta, 3.3.Rritja e numrit të stafit profesional ne qendra burimore, 3.4.Ngritja kapaciteteve të stafit në qendra burimore, 3.5.Hartimi dhe akreditimi i programeve të trajnimeve për mësimdhënësit në shkollat të rregullta, 3.6.Hartimi dhe akreditimi i programeve nga AKK për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave, 3.7.Ofrimi i kurseve për mësimdhënësit, asistente dhe prindër për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave, 3.7.1. Zhvillimi i programit, Niveli 5 ne gjuhën e shenjave.

Treguesi 1: *Numri i dhomave burimore ne shkolla*

Treguesi 2: *Pergatitja e stafit edukativ ne shkrimin Braille dhe gjuhën e shenjave*

Treguesi 3: *Dokumenti përcakton shkollat bilinguale*

Aktiviteti I.3.1 Hartimi i planit 5 vjeçar për qendrat burimore

Përshkrimi i të arriturave: MASHTI raporton se plani 5 vjeçar për qendrat burimore ishte hartuar dhe miratuar përgjatë vitit 2021 ndërsa gjatë vitit 2023 plani veç është në fazën e implementimit ku janë përcaktuar disa objektiva të këtij plani si: a) Ngritja e cilësisë së shërbimeve të QB për arsimin e FNVA; b) Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit të QB; c) Zhvillimi dhe funksionalizimi i partneritetit dhe rrjetëzimit për ngritjen e cilësisë së arsimit gjithëpërfshirës. d) Zhvillimi i kompetencës së shkrim-leximit për nxënësit me dëmtime në dëgjim/shurdhër përmes edukimit bilingual e) Zhvillimi dhe adoptimi i materialeve arsimore në audio, braille dhe tekst të zmadhuar dhe f) Zhvillimi i kompetencave arsimore për nxënës me AK intelektuale dhe të shumëfishta.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

Aktiviteti I.3.2 Rritja e shërbimeve nga qendrat burimore për shkollat e rregullta

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet raportohet se gjatë vitit 2023 ka pasur shërbime funksionale të fokusuara në identifikim, hartimin e planit individual, trajnimet e mësimdhënësve dhe trajnime për asistent.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *10.000€*

Aktiviteti I.3.3 *Ngritja kapaciteteve të stafit në qendra burimore*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MASHTI raporton se 130 mësues specialë nga gjashtë qendrat burimore kanë përmirësuar aftësitë e tyre për të mësuar nxënësit me aftësi të kufizuara të ndryshme dhe për të mundësuar mësimin për të gjithë, duke marrë parasysh nivelet dhe aftësitë e ndryshme të të nxënësve.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *3,500.00€*

Aktiviteti I.3.4 *Hartimi dhe akreditimi i programeve të trajnimeve për mësime-dhënësit në shkollat të rregullta*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet raportohet se gjatë viti 2023 ka pasur programet e hartuara dhe akredituara.

Programet e akredituara në katalog janë realizuar si në vijim:

- Planifikimi sipas nevojave të nxënësve (nxënës me nevoja të veçanta). Hartimi i planit individual të edukimit (PEI) për nxënës me AK
- Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Gjithë përfshirja dhe individualizimi i mësimin për nxënës me nevoja të veçanta (pia)
- Edukimi Inklusiv/ Gjithëpërfshirës
- Hartimi i Planit Individual të Arsimit –PIA
- Vizioni dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, puna e përbashkët dhe mjediset e ndihmojnë të nxënësve të individualizuar...

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Aktiviteti I.3.5 *Hartimi dhe akreditimi i programeve nga AKK për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave*

Përshkrimi i të arriturave: MASHTI raporton se gjatë vitit 2023 janë hartuar dy (2) programe për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

Aktiviteti I.3.6 *Ofrimi i kurseve për mësimdhënës, asistente dhe prindër për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave*

Përshkrimi i të arriturave: Raportohet se gjatë vitit 2023 nuk janë ofruar kurse për mësimdhënës, asistente dhe prindër për shkrimin e Braille dhe gjuhen e shenjave në mungese të donatorëve dhe limitit buxhetor nga MFPT dhe konsiderohet se këto aktivitete janë shtyrë për vitet në vijim.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: 10000 €

Aktiviteti I.3.7 *Zhvillimi i programit, niveli 5 në gjuhen e shenjave*

Përshkrimi i të arriturave: MASHTI raporton se programi i nivelit të 5-të të gjuhës së shenjave është funksionalizuar. Programi është akredituar nga AKK dhe qendra burimore “Nënë Tereza” në Prizren është institucioni bartës i programit.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 3000€

Buxheti përgjithshëm për vitin 2023 për Objektivin Specifik III.3 Të krijohet një mjedis i përshtatshëm për gjithë përfshirje në shkollë dhe komunitet është 17,500.00

OBJEKTIVI SPECIFIK 4: NGRITJA E CILËSISË SË MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIT NE ARSIMIN GJITHËPËRFSHIRËS NË TË GJITHA NIVELET E ARSIMIT PARA-UNIVERSITAR

Objektivi specifik 4: Përfshinë ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar.

Ky objektivi specifik përfshinë 6 aktivitete të cilat janë: 4.1.Hartimi i dokumentit për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të lartë me specifik shkollat e AAP, 4.2.Hartimi i udhëzuesve për mësimdhënës për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara, 4.3.Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për qasjen dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara, 4.4.Ofrimi i arsimit jo formal në qendrat burimore, 4.5 Krijimi i sintezës vokale në gjuhë shqipe, 4.6. Përdorimi i materialeve gjatë procesit të punës së mësimdhënësve (materialet e hartuara nga OJQ-te).

Treguesi 1: *Mësimdhënës të trajnuar në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar*

Aktiviteti I.4.1 *Hartimi i dokumentit për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e mesëm të lartë me specifik shkollat e AAP*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MASHTI raporton se dokumenti “Kornizë për përfshirjen e nxënësve me nevojë të veçanta arsimore në shkollat e mesme të larta” është miratuar në vitin 2021 ngase ky aktiviteti ka qenë i parapare të implementohet përgjatë periudhës së vitit 2021 të Planit të Veprimit dhe si aktivitet është realizuar në po atë vit. Qëllimi kryesor i kornizës është rritja e vazhdueshme e qasjes dhe ofrimi i arsimit cilësor për nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollat e mesme të larta.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: 5000 €

Aktiviteti I.4.2 *Hartimi i udhëzuesve për mësimdhënës për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: Sipas Planit të Veprimit ishte paraparë që Hartimi i udhëzuesve për mësimdhënës për qasjen, punën pedagogjike dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara të realizohet në vitin 2021, kur edhe është zbatuar ky aktivitet. Megjithatë, udhëzuesit e tillë nuk janë hartuar ne mungese te donatoreve, sipas raportimeve nga MASHTI.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: 5000 €

Aktiviteti I.4.3 *Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për qasjen dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve për qasjen dhe specifikat e nxënësve me aftësi të kufizuara u raportua se: 250 profesionistë shkollorë (drejtorë, mësimdhënës, psikologë, prindër nga këshillat e prindërve) nga 25 shkollat pilote kanë përfunduar me sukses programin e trajnimit “Krijimi i një komuniteti demokratik dhe gjithëpërfshirës në shkolla”. 127 profesionistë shkollorë (drejtorë, mësimdhënës, psikologë) nga shkollat e Prishtinës, Gjilanit, Ferizajit dhe Podujevës (92 gra dhe 35 burra) ngritën kapacitetet e tyre me pjesëmarrjen në trajnimin 10 – ditore mbi arsimin gjithëpërfshirës, vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe hartimin e planeve individuale të arsimit. 89 profesionistë nga 6 qendrat burimore (73 gra dhe 16 burra) përfunduan me sukses Modulin I të trajnimit “Aftësia e kufizuar dhe arsimi gjithëpërfshirës” derisa 25 mësimdhënës (15 gra/10 burra) nga Qendra Burimore “Nëna Terezë” në Prizren përfunduan me sukses Modulin 1 të trajnimit mbi metodologjitë e mësimdhënies për nxënësit e shurdhër. Moduli 2 i trajnimit lidhur me metodat e mësimdhënies/mësim nxënies për shkrim/lexim tek të shurdhërit është hartuar dhe dorëzuar në MASHTI për akreditim.

Nderkohë sipas raportit të UNICEF-it për vitin 2023 raportohet se 141 mësues nga shkollat e zgjedhura kanë rritur kapacitetet e tyre për zhvillimin e planeve individuale të arsimit (IEP) për fëmijët me aftësi të kufizuara si pjesë e trajnimit të tyre për arsimin gjithëpërfshirës.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 32,000.00€

Aktiviteti I.4.4 *Ofrimi i arsimit jo formal në qendrat burimore*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MASHTI raporton se edhe gjatë vitit 2023 është ofruar arsimi joformal nëpër qendrat burimore duke potencuar se shkollat i kane të hapura thirrjet për arsim joformal, megjithatë nga shkollat kane raportuar se nuk ka candidate te interesuar.

Për të përmirësuar qasjen arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara, UNICEF në bashkëpunim të ngushtë me Forumin e Aftësisë së Kufizuar të Kosovës (KDF) dhe Drejtorët e Edukimit Komunal (MEDS) themeluan 15 klasa të burimeve në 10 komuna të synu-

ara: Prizren, Prishtina, Lipjan, Peja, Gjiilan, Mitrovica, Mitrovica, Mitrovica, Mitrovica , Podujeva, Viti dhe Gjakova. Këto klasa burimore janë plotësisht funksionale dhe të pajisura me TIK dhe teknologji ndihmëse të përshtatura për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara që kontribuojnë në zbatimin e udhëzimeve administrative për “shndërrimin e klasave të bashkangjitura në dhomat e burimeve”.¹⁸

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto*

Aktiviteti I.4.5 *Përdorimi i materialeve gjate procesit te punës se mësim-dhënësve (materialet e hartuara nga OJQ-te)*

Përshkrimi i të arriturave: Për vitin 2023 raportohet se nuk kanë të dhëna lidhur me materiale të hartuara nga OJQ-të që janë përdorur gjatë procesit të punës së mësimdhënësve.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto*


Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik III.4: Ngritja e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit në arsimin gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet e arsimit para-universitar për vitin 2023 ishte 32,000.00 Euro

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Strategjike 3: Krijimi i kushteve për gjithë përfshirjen në arsim dhe për mbështetjen profesionale të personave me aftësi të kufizuara për vitin 2023 ishte 865,162.00 Euro

Realizimi i objektivave nga fusha e arsimit për Personat me Aftësi të Kufizuar

Nga gjitha aktivitetet e zhvilluara për vitin 2023 nga fusha e arsimit Personat me Aftësi të Kufizuar diagrami i mëposhtëm paraqet përqindjen e aktiviteteve si në vijim:

Shpërndarja e Aktiviteteve në Sektorin e Arsimit



Grafiku i aktiviteteve nga fusha e arsimit për vitin 2023

18 "Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19": Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) USAID-funded project implemented by UNICEF.

MBROJTJE LIGJORE

OBJEKTIVI STRATEGJIK: KRIJIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE PËR RESPEKTIMIN DHE PËRMBUSHJEN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Objektivi strategjik synon të krijojë një bazë ligjore të qartë dhe mbrojtëse për të drejtat dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar që ata të kenë mundësi reale për të jetuar dhe kontribuar në shoqërinë në të cilën jetojnë. Në përgjithësi, krijimi i kësaj infrastrukture ligjore nuk është vetëm një obligim ligjor për shtetin, por gjithashtu është një shenjë e angazhimit të përbashkët për një shoqëri ku diversiteti dhe përfshirja janë vlera themelore. Nëse ky objektivi realizohet me sukses, do të ndihmojë në përmirësimin e kushteve jetësore dhe mundësive të personave me aftësi të kufizuara për të jetuar një jetë të pavarur dhe të plotë në të gjitha aspektet e saj.

OBJEKTIVI SPECIFIK 1: HARTIMI I LIGJEVE NË MBROJTJEN DHE RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSITË KUFIZUARA KU ËSHTË I PËRFSHIRË 1 AKTIVITET:1.1.PËRFSHIRJA E ORGANIZATAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR NE HARTIM TË LEGJISLACIONIT.

Treguesi: *Hartimi i Ligjit për Gjithpërfshirje*

Aktiviteti I.4.1 *Përfshirja e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar ne hartim të legjislacionit*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me pjesëmarrjen e Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar në grupet punuese në hartimi të legjislacionit të MD-së për vitin 2023, Ministria e Drejtësisë ka raportuar se të njëjtët nuk kanë qenë të përfshirë në grupet punuese. Organizatat që përfaqësohen nga kjo kategori, si edhe çdo organizatë tjetër, çdo herë kanë qasje në platformën e konsultimeve me publikun dhe mund të japin kontributin e tyre në këtë formë në hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar të MD-së.

Statusi i progresit: *Nuk është implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë buxhetore*

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik IV.1 nuk është planifikuar kosto shtesë.

OBJEKTIVI SPECIFIK: NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI I KORNIZËS AKTUALE LIGJORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Objektivi Specifik 2: Ndryshimi dhe plotësimi i kornizës aktuale ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar, përfshin rritjen e bashkëpunimit me Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuar përmes konsultimit të tyre në hartimin e politikave qeveritare. Janë të përfshira 2 aktivitete: 1.1.Zbatimi i Rregullores QRK 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve ne Gjuhën e Shenjave, 1.2.Koordinimi rreth Funkcionalizimit të Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar.

Treguesi: Rritja e bashkëpunimit me OPAK përmes konsultimit të tyre në hartimin e politikave qeveritare

Aktiviteti I.2.1 Zbatimi i Rregullores QRK 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave


Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet raportohet se janë ofruar shërbimet e nevojshme. Në diagramin e më poshtëm janë të paraqitura disa të dhëna të ofruara nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit (ZQM/ZKM) në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të Shurdhërve (ShKSh) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023, lidhur me shërbimet e gjuhës së shenjave të ofruara nga interpretët profesionist të gjuhës së shenjave. Të dhënat janë mbledhur nga lista e prenotimeve dhe lista e pagesave për shërbimet e ofruara.

Statusi i progresit: Implementuar


Buxheti i planifikuar: 40,000€

Raporti i vitit 2023 rreth shërbimeve ne gjuhën e shenjave të ofruara nga Shoqata Kosovare e të Shurdhërve									
	Prenotime	Ore	Euro	Mjekësi	Komune	Polici	Gjykate	Ministria	Shkolle
Janar	155	372	3720	74	23	5	3	21	2
Shkurt	211	485	4850	91	31	6	4	33	3
Mars	225	516	5160	83	44	1	4	34	3
Prill	137	341	3410	49	27	11	7	11	4
Maj	209	490	4900	79	53	9	4	20	4
Qershor	211	481	4810	91	37	7	10	28	5
Korrik	180	455	4550	68	36	6	13	12	1
Gusht	183	458	4580	74	41	5	10	17	5
Shtator	190	438	4380	74	49	4	6	12	12
Tetor	171	397	3970	75	30	5	3	24	4
Nentor	194	478	4780	86	48	2	5	13	6
Dhjetor	162	405	4050	49	9	10	4	14	3
Totali	2228	5316	53160	893	428	71	73	239	52

Tabela 4: Shënim: Këto të dhëna janë të mbledhura dhe të paraqitura nga lista e prenotimeve dhe lista e pagesave si dhe nuk është bërë ndonjë analizë për çështje të caktuara



Ndarja e orëve, shuma dhe fushat e ofrimit të shërbimeve lidhur me gjuhën e shenjave periudhën janar-dhjetor 2023




Prenotimet për periudhën janar-dhjetor 2023



Orët e shërbimeve të ofruara lidhur me gjuhën e shenjave për periudhën Janar-Dhjetor 2023



Shuma totale në Euro lidhur me shërbimet e gjuhës së shenjave për periudhën Janar - Dhjetor 2023



Shërbimet në përqindje lidhur me gjuhën e shenjave të ofruara në: mjekësi, shkollë, gjykatë, polici dhe komuna

Aktiviteti I.2.2 *Koordinimi rreth Funkcionalizimit të Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar u ri-themelua me 22 Qershor 2021 nën udhëheqjen e Zëvendëskryeministrit dhe është themeluar të punoj për krijimin e mundësive të barabarta, pjesëmarrjen e plotë dhe integrimin social të personave me aftësi të kufizuar. Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar përcjellë, monitoron dhe shqyrton kushtet e jetesës së personave me aftësi të kufizuar, si dhe rrjedhimisht këshillon Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një kualitet jetësor më të mirë për Personat me Aftësi të Kufizuar. Ky Këshill synon përmbushjen e objektivave strategjike të Strategjisë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2013-2023. Sipas rregullave procedurale ky Këshilli mban takime të Personave me Aftësi të Kufizuar të paktën dy herë në vit. Gjatë viti 2023, Këshilli për Personat me Aftësi të Kufizuara ka mbajtur vetëm një takim me datë 30 Maj (e martë) 2023. Takime tjera nuk janë mbajtur për shkak se gjatë vitit 2023 angazhimi më i madh ka qenë i fokusuar në organizimin e punëtorive për hartimin e strategjisë si dhe punëtori për organizimin e ditëve ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto shtesë buxhetore*

Buxheti i përgjithshëm për Objektivin Specifik IV.2 Koordinimi rreth Funkcionalizimit të Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar i paraparë e ne mjete për vitin 2023 është 40,000.00 Euro

OBJEKTIVI SPECIFIK: NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT PROFESIONAL NË SISTEMIN E DREJTËSISË PËR TË DREJTAT E PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Objektivi Specifik 3: Ngritja e kapaciteteve të stafit profesional në sistemin e drejtësisë për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar përfshin gjithsej 4 aktivitete: 3.1. Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe Korrektuese, 3.2. Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuar në sistemin drejtësisë, 3.3. Ngritja e kapaciteteve të PK-së përmes Trajnimit të zyrtarëve policor për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave mbi specifikat e Personave me Aftësi të Kufizuar, 3.4. Hartimi i udhëzuesit për trajtimin e Personave me Aftësi të Kufizuar bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar.

Treguesi: *Rritja e 30% e trajnimeve mbi specifikat e Personave me Aftësi të Kufizuar në gjithë përfshirje në kuadër të sistemit të drejtësisë dhe sigurisë*

Aktiviteti I.3.1 *Trajnimi i stafit në Shërbimet Sprovuese dhe korrektuese*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MD ka raportuar se për vitin 2023 SHKK/MD ne bashkëpunim me OSBE dhe ASKP, ka organizuar trajnimin në fushën e të drejtave të njeriut meqë rast janë trajnuar 88 zyrtar korrektues.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Aktiviteti I.3.2 Hartimi i udhëzuesit informues për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara në sistemin drejtësisë

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet nga MD është raportuar për hartimin e Protokollit shtetëror për Trajtimin e rasteve të dhunës seksuale- Qëllimi kryesor i këtij Protokollit është standardizimi i veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës e me përgjegjshmëri, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe ri-integrimin e viktimave, të mbijetuarave të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse.

Protokolli synon të kushtoj vëmendje të gjithë viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve të dhunës seksuale, pavarësisht kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinën sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër¹⁹.

Ministria e Drejtësisë ka organizuar fushatën “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” ,fushatë vjetore fillon më 25 nëntor – në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave dhe ka vazhduar deri më 10 dhjetor – në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Gjatë fushatës janë organizuar mbi 80 aktivitete që kanë adresuar çështjen komplekse dhe fenomenonin e dhunës me bazë gjinore në tërë territorin e Republikës së Kosovës²⁰.

Sipas raportit të UNICEF-it për vitin 2023 “Strengthened child protection and education systems for the inclusion of vulnerable children during and beyond COVID-19”: Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023) projekt i USAID-it i implementuar nga UNICEF, me qëllim që t’u sigurojë fëmijëve dhe të rinjve mundësi për të diskutuar ndjenjat, të ndjehen të sigurt për të shprehur mendimet dhe përvojat e tyre në lidhje me kujdesin e kujdestarisë, por edhe të ndërtojnë miqësi të reja me fëmijët e tjerë në farefisninë dhe kujdestarinë, projekti për të mbështetur krijimin e bashkëmoshatarëve- Tri grupet e Rrjetit To-Peer nga bashkëmoshatarët me 33 fëmijë (12 vajza dhe 21 djem) për kujdesin e kujdestarisë dhe lidhjet farefisnore u krijuan në Gjakovë, Pejë dhe Prishtinë Këto grupe ishin të dobishme për të edukuar fëmijët në lidhje me të drejtat e tyre dhe t’i njohin ata me mekanizmat e disponueshëm për ankesa dhe të kërkojnë mbrojtje në rastet e ngacmimit, abuzimit ose shkeljeve të të drejtave. Përmes organizimit të aktiviteteve rekreative dhe lojërave arsimore, një mjedis ushqyes u nxit për t’u mundësuar fëmijëve të shprehin lirshëm emocionet e tyre, të diskutojnë sfidat, të angazhohen në komunikim konstruktiv dhe të ndërtojnë miqësi të reja.

19 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/04F016B5-48F2-4DB3-A595-D320114AC25D.pdf>

20 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/E732F69C-56BD-4CEC-ABEA-04BE3F757839.pdf>

Gjatë vitit 2023 Ministria e Drejtësisë bazuar në thirrjen publike për mbështetje të projekteve për Organizatat jo-qeveritare të licencuara ka mbështetur OJQ me projektet që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:


- Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;
- Shërbime rezidenciale dhe ditore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit;
- Shërbime alternative për fëmijë pa kujdes prindëror dhe këshillime për familjet strehuese, për zbatimin e programit të strehimit familjar;
- Shërbime alternative për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese për ofrimin e shërbimeve për fëmijë;
- Shërbime rezidenciale për mbrojtje të fëmijëve të braktisur dhe mbështetjen e familjeve strehuese me këshilla profesionale;
- Shërbime rezidenciale dhe ditore për largimin e fëmijëve nga punët e rënda e të rrezikshme dhe kërkimi i lëmshës;
- Shërbime, rezidenciale, ditore dhe në familje për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara;
- Shërbime të rehabilitimit dhe trajtimit për personat me nevoja të veçanta fëmijë dhe të rritur (të verbëritë, të shurdhër, tetraplegjike, paraplegjike, me down sindrom, autizem etj)
- Shërbime të mbrojtjes, këshillimeve psiko-sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.
- Shërbime, rezidenciale, ditore dhe në familje për personat e moshuar dhe pa përkuqdesje familjare.

Vlera totale e mbështetjes për të gjitha OJQ-të e licencuara është 1,500,000.00 euro.

Ministria e Drejtësisë menaxhon me data baza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, ku evidentohen të dhënat nga të gjithë akteret që ofrojnë shërbime për rastet e dhunës në familje (policia, gjykata, prokuroria, mbrojtësit e viktimave, qendrat për punë sociale, strehimoret). Nga data baza gjenerohen të dhënat edhe për Personat me Aftësi të Kufizuara. Statistikat e gjeneruara nga data baza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje, janë paraqitur si në vijim të dhënat sipas: viktimave, kryesve, gjinisë, moshës dhe sipas etnicitetit për Personat me Aftësi të Kufizuara :

Numri i viktimave 72 prej tyre janë 50 femra dhe 22 meshkuj. Shqiptar 60, Serb 6, Boshnjak 2, Ashkali 3, Egjiptian 1. Numri i kryesve 28 prej tyre janë 24 meshkuj dhe 4 femra. Shqiptar 23, Serb 1, Boshnjak 1, Ashkali 2 dhe Egjiptian 1²¹

21 <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,184>



Këto grafikë tregojnë shpërndarjen e viktimave dhe kryesve sipas gjinisë dhe etnisë

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Aktiviteti I.3.3 *Ngritja e kapaciteteve të PK-së përmes trajnimit të zyrtarëve të policisë për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave mbi specifikat e Personat me Aftësi të Kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: Gjatë vitit 2023 në Policinë e Kosovës janë trajnuar 1651 zyrtar Policor lidhur me trajtimin dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Kapacitetet janë ngritur përmes trajnimeve, punëtorive, konferencave dhe tryezave të rrumbullakëta.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Aktiviteti I.3.4 *Hartimi i udhëzuesit për trajtimin e Personave me Aftësi të Kufizuar bazuar në specifikat e aftësisë së kufizuar.*


Përshkrimi i të arriturave: Policia e Kosovës në Dhjetor të vitit 2022 ka aprovuar Procedurën standarde të veprimit për qasje cilësore gjithë përfshirëse për Personat me Aftësi të Kufizuara. Pra në vend të udhëzuesit është hartuar kjo PSV.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto buxhetore*

Realizimi i objektivave nga fusha e mbrojtjes ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar

Nga gjitha aktivitetet e zhvilluara për vitin 2023 nga fusha e mbrojtjes ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuar diagrami i mëposhtëm paraqet përqindjen e aktiviteteve si në vijim:



Grafiku i aktiviteteve nga fusha e Mbrojtjes ligjore për vitin 2023

QASJE DHE KOMUNIKIM

OBJEKTIVI STRATEGJIK: KRIJIMI I KUSHTEVE TË BARABARTA NË QASJE, INFORMIM, KOMUNIKIM, PJESËMARRJE SI DHE KRIJIMIN E NJË SISTEMI TË UNIFIKUAR TË TË DHËNAVE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Objektivi Specifik 1: Hulumtimi sipas nevojës mbi gjendjen në terren lidhur me qasjen në objekte për Personat me Aftësi të Kufizuar që përfshin 9 aktivitetet të cilat janë: 1.1. Aktiviteteve vetëdijësuese me këtë komunitet, respektivisht takime me OJQ-të që paraqesin interesat e personave me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë integrimi dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, 1.2. Punëtori e organizuara për OJQ-të për Personat me Aftësi të Kufizuar, 1.3 Fushatë vetëdijësuese mbi grandet në bujqësi për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe prindërit e fëmijëve të Personave me Aftësi të Kufizuar MB-PZHR, 1.4. Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në zonat rurale për mundësinë e aplikimit në subvencione dhe grante, 1.5 Promovimi, bashkëpunimi dhe avancimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në komuna, 1.6. Promovimi i të drejtave të njeriut në komuna/. Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar plotësisht në jetën shoqërore me kushte të barabarta si të gjithë, 1.7 Themelimi / fuqizimi i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar, 1.8 Fushatë informuese për ofrimin e Ndihmës Juridike Falas tek organizatat e personave me aftësi të kufizuara, 1.9 Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar në komuna.

Treguesi 1: *Pasqyrimi i gjendjes reale të objekteve të ashpër për Personat me Aftësi të Kufizuar*

Treguesi 2: *Sigurimi i qasjes në institucione publike*

Aktiviteti I.1.1 *Aktiviteteve vetëdijësuese me këtë komunitet, respektivisht takime me OJQ-të që paraqesin interesat e personave me aftësi të kufizuara, me theks të veçantë integrimi dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara.*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet MPBZHR raporton se gjatë vitit 2023 është bërë rishikimi i Ligjit Nr05/L-021 për mbrojtje nga Diskriminimi ku kanë ndarë disa nene që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara; Rishikimi i Rregullores QRK-Nr.03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi në qeveri dhe komuna; Rishikimi i Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr-01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme si; dhe Rishikimi i Udhëzimit Administrativ Nr.09/2010 për caktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar në përputhje me aftësitë e tyre të punës. Poashtu raportohet për pjesëmarrje në Marshin e organizuar nga shoqata "Autizmi" për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Autizëm. Pjesëmarrje në Konferencën e organizuar nga ZQM/ZKM dhe Handikos me rastin e shënimit të 3 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar "Mundësi të barabarta për të gjithë". Me ftesë të Handikosit Dega në Kaçanik dhe të Komunës së Kaçanikut është bërë përurimi i Objektivit të Handikosit-Kaçanik, i ndërtuar me participimin e Komunës së 50% të objektivit dhe pjesa tjetër e mbështetur nga organizata Ndërkombëtare bamirëse LDS Charities. U raportua për pjesëmarrje në Eventin e organizuar nga Am-

basadorja e Vullnetit të Mirë për Kosovën, dhe në bashkëpunim me Ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë ku në këtë organizim është bërë dekorimi i grave nga grupe të marginalizuara që dhanë kontribut të vazhdueshëm në fushën e të drejtave të njeriut në Kosovë me trofeun “Hyjnesha e Shtetit” e cila u mbajti me 7.12.2023 ku ne mesin e 33 grave kishte edhe femra me aftësi të kufizuara.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 500 €

Aktiviteti I.1.2 *Punëtorit e organizuara për OJQ-të për Personat me Aftësi të Kufizuar*

Përshkrimi i të arriturave: MPBZHR lidhur me këtë aktivitet për vitin 2023 ka raportuar organizimin e eventit nga ZQM/ZKM, Handikos në Kaçanik dhe Ambasadorja e Vullnetit të Mirë për Kosovën.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 500€

I.1.3 *Fushatë vetëdisuese mbi grandeve në bujqësi për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe prindërit e fëmijëve të Personave me Aftësi të Kufizuar, MB-PZHR*

Përshkrimi i të arriturave: përkritazi me fushatën vetëdijësuese mbi grantet në bujqësi për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe prindërit e fëmijëve të Personave me Aftësi të Kufizuar, MPBZHR ka raportuar për organizimin e një takimi me shoqatën e invalidëve të luftës me qëllim të mbajtjes së kontakteve të vazhdueshme për takimet e rradhës rreth fermerëve me aftësi të Kufizuar të cilët janë invalid të luftës.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: 500€

Aktiviteti I.1.4 *Promovimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar në zonat rurale për mundësinë e aplikimit në subvencione dhe grande.*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me këtë aktivitet për vitin 2023 u raportua mbi organizimin e një takimi me shoqatën e invalidëve civil dhe viktimave të luftës ku u diskutua rreth fermerëve me aftësi të kufizuar me sakte nga shoqata e tyre. Poashtu, takim me drejtorin e drejtorisë së Bujqësisë në Kaçanik ku u diskutua rreth listës së fermerëve me aftësi të kufizuar. Ndërkohë është siguruar lista e fermerëve të Komunës së Kaçanikut ku katër nga fermerët ishin përfitues edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe u diskutua për vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm dhe u diskutua mbi vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm.

Statusi i progresit: *Në proces të zbatimit*

Buxheti i planifikuar: 500€

Objektivi Specifik 2: Sigurimi i qasjes në objekte për Personat me Aftësi të Kufizuar ku përfshihen këto aktivitet

Aktiviteti I.1.5 *Promovimi, bashkëpunimi dhe avancimi i të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar në komuna*

Përshkrimi i të arriturave: për vitin 2023 është raportuar nga MAPL se kjo Ministri në koordinim me MMPH, kanë monitoruar funksionimin e Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuar, dhe sipas të dhënave është funksionalizuar në 19 komuna, ndërsa në 14 komuna (Skenderaj, Rahovec, Dragash, Pejë, Kaçanik, Prishtinë, Shtërpçë, Istog, Partesh, Kllokot, Podujevë, Ranillug, Shtime, Novobërdë) nuk është themeluar.

Sa i përket ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në 6 komuna (Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë Jugore) është funksionalizuar Zyra Rajonale për Ndihmë Juridike Falas. Ndërsa zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike, janë themeluar në 20 komuna (Klinë, Dragash, Glllogoc, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Rahovec, Skenderaj, Istog, Kamenicë, Prizren, Ranillug, Gjakovë, Gjilan, Obiliq, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri)

Gjithashtu është inicuar shkresa në bashkëpunim me Shoqatën e të shurdhëve për projektin e gjuhës së shenjave në ueb faqen e komunës. Pas Prishtinës, janë komunat: Gjilan dhe Suharekë. Në komunat Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë e Jugut dhe Mamushë së bashku me MMPH, si dhe SHKSH, është adresuar si çështje gjuhën e shenjave.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 500€

Aktiviteti I.1.6 *Promovimi i të drejtave të njeriut në komuna/Personat me Aftësi të Kufizuar . Përfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar plotësisht në jetën shoqërore me kushte të barabarta si të gjithë.*

Përshkrimi i të arriturave: Për vitin 2023 lidhur me këtë aktivitet MAPL raporton se në kuadër të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi komunat janë të obliguar të caktojnë njësinë apo zyrtarin përkatës për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e këtij ligji dhe sipas të dhënave zyrtare rezulton se deri më tani në 30 komuna (Klinë, Skenderaj, Rahovec, Deçan, Junik, Dragash, Hani Elezit, Prishtinë, Shtërpçë, Graçanicë, Istog, Kamenicë, Partesh, Pejë, Prizren, Podujevë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Suharekë, Fushë Kosovë, Malishevë, Shtime, Vushtrri, Mitrovicë Jugore, Mitrovica e veriut, Lipjan, Viti, Zvečan, Leposavic,) është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimit, ndërsa në 7 komuna (Glllogoc, Kaçanik, Kllokot, Ranillug, Obiliq, Mamushë, Novobërdë, Zubin-Potok) akoma nuk është emëruar.

Përkitazi me organizimin e takimeve, trajnimeve, fushatave ndërgjegjësuëse, punëtorive për mbrojtje nga diskriminimi janë 29 komuna të cilat kanë raportuar: Deçan, Dragash, Glllogoc, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Gjilan, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Mitrovica e Jugut, Novobërdë, Obiliq, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Junik, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suharekë, Viti, Vushtrri, Hani i Elezit.

Si u raportua nga UNICEF-i, Më 20 shtator 2023, në partneritet me Zyrën e Qeverisjes së Mirë u fillua një fushatë 22-mujore për të rritur ndërgjegjësimin publik për pengesat e

përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, dhe për të kërkuar realizimin e plotë të të drejtatë fëmijët me aftësi të kufizuara. Fushata u përqendrua në katër objektiva kryesore:

a) avokim për miratimin e ligjit që i vë fëmijët në qendër, b) të mundësojë hapësira publike të arritshme për të gjithë fëmijët, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, veçanërisht në fushat e lojërave, objektet shëndetësore, klasat dhe tualetet, c) mjedisi gjithëpërfshirës, ku të gjithë fëmijët kanë të drejtë të mësojnë së bashku në të njëjtat shkolla, luajmë së bashku në të njëjtën shesh lojrash.²²

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: 1000€

Aktiviteti I.1.7 *Hartimi i Planit Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuar në komuna*

Përshkrimi i të arriturave: Përkitazi me këtë aktivitet për vitin 2023, MAPL- MMPH, raportojnë lidhur me planin e punës në 25 komuna të cilat kanë raportuar si në vijim: Dragash, Obiliq, Partesh, Prizren, Vushtrri, Gjilan, Decan, Gllogoc, Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Istog, Hani Elizi, Mamushë, Rahovecë, Prishtinë, Malishevë, Novobërdë, Pejë, Skenderaj, Suharekë, Junik, Mitrovica e Jugut, Viti, Kamenicë, Nga 25 Komuna, 6 komuna e kanë të hartuar Planin e Punës: Mamushë, Prishtinë, Suharekë, Skenderaj, Gjakovë, Fushë Kosovë gjersa dy komuna janë në proces: Mitrovicë e Jugut, dhe Dragashi.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

OBJEKTIVI SPECIFIK: SIGURIMI I QASJES NË OBJEKTE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Treguesi 1: *Qasje në institucione publike*

Treguesi 2: *Qasje në institucione shëndetësore*

Treguesi 3: *Qasje në institucione arsimore*

Aktiviteti I.2.1 *Zbatimi i Udhëzimit Administrativ 33/2007 "Për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar"*

Përshkrimi i të arriturave: Lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ 33/2007 "Për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar" MEA raporton se janë realizuar dy matje rreth zbatimit të UA 33/2007 në vit.

Statusi i progresit: *Implementuar*

Buxheti i planifikuar: *Nuk ka kosto financiare*

22 "Protecting Vulnerable Children in Kosovo: Second Progress Report (1 Jan–31 Dec 2023)," EU-funded project implemented by UNICEF.

Sipas raportimit të bërë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me zbatimin e masave të planit kombëtar të veprimit për persona me aftësi të kufizuara i Republikës së Kosovës për vitin 2023, aktivitetet e komunave lidhur me Qasjen e lejuar janë zhvilluar si në vijim:

Dragash: Hotele dhe ndërtesa të ngjashme janë raportuar 1 Qasja ekzistuese (këtu:QE) dhe 1 Qasja e lejuar (këtu: QL), Ndërtesat afariste dhe administrative QE 3, Muzetë dhe Bibliotekat QE 4, Ndërtesa shkollore dhe ndërtesa për qëllime kërkimore shkencore QE 17, Spitale dhe ndërtesa tjera të kujdesit shëndetësor QE 7, Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 5, Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QE 7.

Në Gjakovë: Ndërtesa banimi me shumë njësi QE 4, Ndërtesat afariste dhe administrative QE1, Spitale dhe ndërtesa tjera të kujdesit shëndetësor QE 1, Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QE 35.

Në Glllogoc: Ndërtesa banimi me shumë njësi QL 5, Ndërtesat afariste dhe administrative QL 4, Ndërtesa shkollore dhe ndërtesa për qëllime kërkimore shkencore QE 33, Spitale dhe ndërtesa tjera të kujdesit shëndetësor QE 4+11 dhe QL1 dhe Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QE 582 m.

Në Istog: Ndërtesa për banim të përbashkët QL 2, Hotele dhe ndërtesa të ngjashme QL 2, Spitale dhe ndërtesa tjera të kujdesit shëndetësor QL 1 dhe Ndërtesa për kryerjen e ritualeve fetare dhe religjioze QL 1.

Në Kamenicë: Ndërtesa banimi me shumë njësi QL 1, Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QL 15 dhe të tjera QL 1.

Në Malishevë: Ndërtesa banimi me shumë njësi QL 3, Ndërtesa dhe stacione për trafik dhe komunikacion rrugor QE 1, Ndërtesa shkollore dhe ndërtesa për qëllime kërkimore shkencore QE 17, Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 1 dhe Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QE 1.

Në Obiliq: Ndërtesa banimi me shumë njësi raportohet që qasja ekzistuese (QE) ishte 20 ndërsa qasja lejuese (QL) 11, Ndërtesa për banim të përbashkët, QE 11 ndërsa QL 95, Ndërtesat afariste dhe administrative: QE 3 dhe QL 75, Ndërtesa për aktivitete kulturo-artistike dhe argëtuese QE 0 dhe QL 133, Muzetë dhe Bibliotekat QE 2 dhe QL 225, Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 0 dhe QL 5 dhe Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QE 9 dhe QL 125+M71:Ë125.


Në Podujevë: Hotele dhe ndërtesa të ngjashme QE 1 dhe QL 1, Ndërtesa shkollore dhe ndërtesa për qëllime kërkimore shkencore QL 3, Spitale dhe ndërtesa tjera të kujdesit shëndetësor QE 1 dhe Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 1.

Në Shtime: Ndërtesa për banim te përbashkët QE 6 dhe QL 6, Hotele dhe ndërtesa te ngjashme QE 1 dhe QL 1, Ndërtesat afariste dhe administrative QE 1 dhe QL 1, Muzetë dhe Bibliotekat QE 1 dhe QL 1 dhe Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 1 dhe QL 1.

Në Skenderaj: Ndërtesa banimi me shumë njësi QL 1, Ndërtesa për banim te përbashkët QL 43, Hotele dhe ndërtesa te ngjashme QL 1, Ndërtesat afariste dhe administrative QL 3, Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QL 2 dhe Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QL 6.

Në Suharekë: Ndërtesa banimi me shumë njësi QE 5 ndërsa QL 5, Ndërtesa për banim te përbashkët QE 5 dhe QL 5, Ndërtesat afariste dhe administrative QE 1 dhe QL 1, Ndërtesa për aktivitete kulturo-artistike dhe argëtuese: QE 1 dhe QL 1, Spitale dhe ndërtesa tjera te kujdesit shëndetësor QE 2 dhe QL 2 si dhe Qendra rekreative-sportive, stadiume dhe salla sportive QE 2 dhe QL 2.

Në Vushtri: Ndërtesa banimi me shumë njësi QE 7, Ndërtesa për banim te përbashkët QE 2, Hotele dhe ndërtesa te ngjashme QE 1, Ndërtesa shkollore dhe ndërtesa për qëllime kërkimore shkencore QL 1 dhe Sipërfaqet dhe hapësirat publike (sheshet e këmbësorëve, rrugët, trotualet, ishujt e këmbësorëve, shtegu në park, nënkalimi, mbikalimi dhe ura për këmbësorë, kalimi rrugor dhe të ngjashme) QL 1.



Qasja e ekzistuese dhe e lejuar sipas komunave e paraqitur në mënyrë grafike nga aktiviteti 2.1

Buxheti i përgjithshëm për Objektivën Strategjike V “Krijimi i kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim, pjesëmarrje si dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për Personat me Aftësi të Kufizuara” është 3,500.00 Euro.

Buxheti i përgjithshëm për “Planin e Veprimit 2021-2023” është 39,912,542.00

Sipas raportimeve nga MAPL në diagramin e poshtëm lidhur me matjen e rrugëve komunale dhe infrastrukturës përcjellëse që janë nën kompetencën e komunës. Fusha është e plotësuar me tregues të ri për të nxitur përmirësimin e infrastrukturës rrugore me trotuare, ndriçim, shenjëzim si dhe shteg të biçikletave. Performanca e përgjithshme vlerësohet në shkallë prej 55.05% si në diagramin e poshtëm:




Tabela 9: Treguesit e performancës në fushën e infrastrukturës rrugore

Ministria raporton se ajo çfarë e bënë performancën e përgjithshme të mos jetë aq e lartë, është përfshirja e treguesit të ri për rrugët në zonat urbane me shtigje të biçikletave, si dhe raporti në mes të rrugëve lokale me trotuare dhe ndriçim publik. Vlen të përmendet treguesi me nivelin më të ulët, rrugët në zonën urbane me shteg të biçikletave 7.38% dhe treguesi me përmbushjen më të lartë prej 83.73% rrugët lokale të ri-asfaltuara 8.73. Performanca e komunave në nivel të fushës është paraqitur si më poshtë:





Tabela 10: Të dhënat krahasimore në mes të komunave në fushën e infrastrukturës rrugore

Realizimi i objektivave nga fusha e qasjes dhe komunikimit për Personat me Aftësi të Kufizuar


Nga gjitha aktivitetet e zhvilluara për vitin 2023 nga fusha e Qasjes dhe Komunikimit për Personat me Aftësi të Kufizuar diagrami i mëposhtëm paraqet përqindjen e aktiviteteve si në vijim:

Përqindja e aktiviteteve në fushën e qasjes dhe komunikimit



Grafiku i aktiviteteve nga fusha e qasjes dhe komunikimit për vitin 2023

Në përfundim, duke pasur parasysh të gjitha fushat e përcaktuara me Planin e Veprimit dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2023 për Personat me Aftësi të Kufizuara, është përpiluar diagrami i cili përfshin gjitha fushat si në vijim:



Diagrami i statusit të aktiviteteve nga gjitha fushat e përcaktuara me Planin e Veprimit për vitin 2023

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2023) në fushën e shëndetësisë

Gjatë periudhës 2021-2023, ka pasur përparime të konsiderueshme në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara (Shumë komuna kanë zbatuar vizita shtëpiake për Personat me Aftësi të Kufizuara, duke kontribuar në rritjen e aksesit dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor për këtë grup të popullatës.

Sfidat

- E para, ka mungesë të trajnimeve të vazhdueshme dhe të veçanta për stafin shëndetësor në qasjen dhe trajtimin e këtyre personave, me disa komuna që raportojnë mungesë të mundësive për trajnime të tilla.
- E dyta, ka një mungesë të koordinimit dhe shfrytëzimit të kartelave shëndetësore për Personat me Aftësi të Kufizuara në disa qendra shëndetësore, duke penguar ndjekjen e rregullt të shërbimeve dhe vlerësimin e cilësisë së tyre.
- E treta, mungesa e rezultateve të qarta nga pyetëtorët e kënaqshmërisë për shërbimet shëndetësore të ofruara për këta persona, duke bërë të vështirë vlerësimin dhe përmirësimin e këtyre shërbimeve në mënyrë efektive.

Rekomandime:

- Përmirësimi i Koordinimit dhe Monitorimit duke siguruar që të gjitha qendrat shëndetësore dhe organizatat të koordinohen efektivisht për ofrimin e shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit për të matur dhe raportuar efektivisht përparimin dhe përfitueshmërinë e shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara
- Trajnime të vazhdueshme dhe zhvillimi profesional duke u shtuar numri dhe shtrirja e trajnimeve për personelin shëndetësor në çështjet e qasjes dhe trajtimit të personave me aftësi të kufizuara.
- Krijimi i programeve të strukturuar për zhvillimin profesional të infermierëve dhe stafit mbështetës për të përmirësuar kujdesin dhe qasjen ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara
- Investim më i madh në infrastrukturë dhe pajisje për të lehtësuar qasjen e personave me aftësi të kufizuara në shërbimet fizioterapeutike dhe terapi.
- Të mundësohet që gjitha qendrat shëndetësore të kenë nevojat e përshtatshme për Personat me Aftësi të Kufizuara, si karrige invalidore dhe rregullime të objekteve fizike.
- Promovimi i edukimit shëndetësor dhe vetëdijesimit përmes intensifikimit të fushatave dhe aktiviteteve për edukimin shëndetësor të personave me aftësi të kufizuara dhe të punëtorëve shëndetësor.

Konkluzione dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2023) në fushën e mirëqenies sociale

Raporti mbi realizimin e objektivave nga sfera e mirëqenies sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara në vitin 2023 tregon rezultate pozitive në disa aktivitete kryesore. Implementimi i skemës pensionale për Personat me Aftësi të Kufizuara arriti të përfshijë 20,616 përfitues derisa skemat për kompensimin e personave të verbër dhe atyre paraplegjikë e tetraplegjikë gjithashtu u zbatuan me sukses. Licencimi i OJQ-ve dhe vazhdimi i shërbimeve në qendrat rezidenciale kanë përparuar në mënyrë të vazhdueshme.

Sfidat:

- Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar nuk janë draftuar ende për shkak të mungesës së finalizimit të Projektligjit për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Transferimi i menaxhimit të Institutit Special Shtime dhe Shtëpisë së Fëmijëve Shtime tek Ministria e Shëndetësisë përfshiu ndryshime në detyrat dhe obligimet ligjore, të cilat mund të kenë krijuar sfida në koordinimin dhe ofrimin e shërbimeve.
- Mbetet sfidë e vazhdimi i monitorimit dhe inspektimit efektiv të shërbimeve dhe fondeve të organizatave përfituese për të siguruar që të gjitha fondet dhe shërbimet po përdoren në mënyrë të duhur.
- Përfshirja e vazhdueshme e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës mbetet një prioritet për të arritur barazi dhe mirëqenie sociale.

Rekomandime:

- Është e domosdoshme që të rritet bashkëpunimi ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera për të siguruar implementimin e suksesshëm të skemave pensionale dhe kompensimeve.
- Trajnimi i vazhdueshëm i Komisionit Bio-Psiko-Social dhe personelit të OJQ-ve për përdorimin e instrumenteve të avancuara dhe për ofrimin e shërbimeve cilësore.
- Urgjentisht duhet të finalizohet hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit Gjithëpërfshirës të Aftësisë së Kufizuar.
- Rritja e fushatave vetëdijësuese për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në sektorin publik dhe privat për të siguruar barazi në tregun e punës.

Konkluzione dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2023) në fushën e Arsimit

Nga raporti konkudohet se aktivitetet e planifikuara nuk janë realizuar plotësisht për shkak të mungesës së mbështetjes financiare dhe largimit të donatorëve. Aktivitetet e tilla si hartimi i udhëzuesve dhe trajnimi i edukatorëve nuk janë implementuar, ndërsa platformat pedagogjike kanë funksionuar vetëm pjesërisht dhe fushata vetëdijësuese është anuluar. Përkundër këtyre sfidave, është arritur njëfarë suksesi me mbështetjen e Save the Children për platformat edukative. Kjo situatë nënvizon nevojën për sigurimin e resurseve dhe mbështetjes së qëndrueshme për realizimin e objektivave të këtij projekti.

Sfidat:

- Mungesa e financimit dhe mbështetjes financiare ngase shumë nga aktivitetet nuk janë implementuar për shkak të mungesës së buxhetit dhe mbështetjes financiare nga donatorët ose buxheti i shtetit.
- Mungesa e hartimit të udhëzuesve dhe trajnimeve për personelin arsimor për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara ka qenë një sfidë kryesore.
- Implementimi i pjesërishëm i hartimit dhe ofrimit të materialeve pedagogjike në platformat e MASH-it tregon sfida në përdorimin e teknologjisë për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Edhe pse disa aktivitete janë realizuar, ka sfida në mobilizimin dhe sigurimin e mësuesve dhe asistentëve mbështetës për shkollat dhe qendrat burimore.

Rekomandime:

- Rritja e investimeve dhe buxhetit për arsim për të siguruar burime më të mjaftueshme për shkollat dhe qendrat arsimore, duke përfshirë infrastrukturën, teknologjinë dhe trajnimin e mësuesve.
- Përmirësimi i koordinimit dhe partneritetit mes institucioneve arsimore, qeverisë, organeve në nivel lokale dhe organizatave joqeveritare për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e projekteve arsimore lidhur me Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Hartimi i udhëzimeve të qarta dhe të përdorshme për mësuesit dhe trajnimet e tyre për të përmirësuar ofrimin e arsimit cilësor për të gjithë nxënësit, duke përfshirë dhe përfituar fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Promovimi dhe mbështetja për përdorimin e platformave dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie për të rritur aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuara .
- Investimi në trajnime të vazhdueshme dhe zhvillim profesional për mësuesit dhe personelin e arsimor për të përmirësuar aftësitë e tyre në përballje me sfidat aktuale në arsim me Personat me Aftësi të Kufizuara .

Konkluzione dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2023) në fushën e Mbrojtjes ligjore

Raporti për vitin 2023 në fushën e mbrojtjes ligjore për Personat me Aftësi të Kufizuara përqendrohet në krijimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ligjore për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave. Ndër aktivitetet kryesore të përfshira janë hartimi i ligjeve dhe përfshirja e organizatave përkatëse në procesin legjislativ, zbatimi i rregulloreve për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave, dhe koordinimi për funksionalizimin e Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuara. Përmirësimet përfshijnë gjithashtu trajnimin e stafit profesional në sistemin e drejtësisë dhe ofrimin e shërbimeve specifike për këtë kategori, duke synuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe integruese për Personat me Aftësi të Kufizuara. Implementimi i këtyre masave tregon një angazhim të qartë për të krijuar një shoqëri më të barabartë dhe të përfshirë.

Sfidat:

- Përfshirja e Organizatave për Personat me Aftësi të Kufizuar në procesin legjislativ ngase organizatat që përfaqësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara nuk janë përfshirë në grupet punuese për hartimin e legjislacionit, duke i lënë ata jashtë vendim-marrjes dhe konsultimeve të rëndësishme.
- Edhe pse janë ofruar shërbimet e nevojshme, zbatimi i Rregullores për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave kërkon përmirësime të mëtejshme për të siguruar akses të plotë dhe efektiv për të gjithë.
- Ndonëse Këshilli për Persona me Aftësi të Kufizuar është ri-themeluar, mbetet e paqartë nëse janë mbajtur takimet e nevojshme dhe nëse është arritur një koordinim efektiv për realizimin e objektivave strategjike.
- Përkundër trajnimeve dhe aktiviteteve të organizuara, nevoja për ngritjen e kapaciteteve të stafit në sistemin e drejtësisë mbetet një sfidë për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të drejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara.
- Shumë nga aktivitetet dhe objektivat nuk kanë kosto shtesë buxhetore të planifikuara, duke krijuar vështirësi në realizimin efektiv dhe të qëndrueshëm të tyre.
- Edhe pse ekziston një platformë për konsultime me publikun, pjesëmarrja e organizatave të personave me aftësi të kufizuara në këtë proces mbetet e ulët, duke kufizuar ndikimin e tyre në hartimin e politikave dhe legjislacionit.

Rekomandime:

- Të sigurohet përfshirja aktive e organizatave që përfaqësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara në të gjitha fazat e hartimit të legjislacionit.
- Të përmirësohet zbatimi i Rregullores për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave, duke siguruar burime të mjaftueshme dhe mbështetje për interpretët e gjuhës së shenjave.
- Të përmirësohet koordinimi dhe funksionalizimi i Këshillit Nacional për Aftësinë e Kufizuar, duke siguruar që takimet e rregullta të mbahen dhe që këshilli të ketë një ndikim të dukshëm në politikë bërjen për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Të planifikohen dhe të sigurohen fonde të mjaftueshme për realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara, për të siguruar një zbatim efektiv dhe të qëndrueshëm të politikave dhe shërbimeve për Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Të inkurajohet dhe të përmirësohet pjesëmarrja e organizatave të personave me aftësi të kufizuara në proceset e konsultimit publik, duke siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në hartimin e politikave dhe legjislacionit.

Konkluzione dhe rekomandime mbi zbatimin e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2023) në fushën e Qasjes dhe Komunikimit

Nga raporti për aktivitetet e personave me aftësi të kufizuara në fushën e qasjes dhe komunikimit del se janë ndërmarrë një sërë iniciativash për përmirësimin e kushteve të tyre, përfshirë promovimin e të drejtave, rritjen e ndërgjegjësimit dhe ofrimin e ndihmës juridike falas. Janë organizuar aktivitete vetëdijësuese dhe bashkëpunuese me OJQ-të

dhe institucionet publike për të përmirësuar qasjen në objekte dhe informacion, ndërkohë që disa komuna kanë bërë progres në funksionalizimin e Komiteteve Konsultative për Personat me Aftësi të Kufizuara. Megjithatë janë shënuar arritje të rëndësishme, ka ende nevojë për përmirësime në zbatimin e rregulloreve dhe sigurimin e qasjes së plotë në objekte për të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara.

Sfidat:

- Shumë objekte publike ende nuk janë të qasshme për Personat me Aftësi të Kufizuara, gjë që pengon pjesëmarrjen e tyre të plotë në jetën publike.
- Ka ende mungesë të ndërgjegjësimit në mesin e komunitetit dhe institucioneve për nevojat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Në disa komuna, Komitetet Konsultative për Personat me Aftësi të Kufizuara nuk janë funksionalizuar ende, gjë që kufizon përfaqësimin e tyre në vendimmarrje.
- Ka nevojë për përmirësime të mëtejshme në infrastrukturë për të siguruar qasje të plotë dhe të sigurtë për të gjithë Personat me Aftësi të Kufizuara.
- Ka mungesë të shërbimeve mbështetëse dhe ndihmës juridike falas për Personat me Aftësi të Kufizuara në disa zona.

Rekomandime:

- Përforcimi i mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të rregulloreve ekzistuese për qasjen.
- Investimi në përmirësimin e infrastrukturës për të siguruar qasje të plotë dhe të barabartë për Personat me Aftësi të Kufizuara në të gjitha objektet publike.
- Fushata të vazhdueshme të ndërgjegjësimit për të rritur njohuritë dhe kuptimin e nevojave dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
- Aktivizimi dhe fuqizimi i Komiteteve Konsultative për Personat me Aftësi të Kufizuara në të gjitha komunat për të siguruar përfaqësim dhe pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse.
- Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve mbështetëse dhe ndihmës juridike falas për Personat me Aftësi të Kufizuara, veçanërisht në zonat më të izoluara.
- Organizimi i programeve të trajnimit për personelin publik dhe privat për të përmirësuar shërbimet dhe qasjen për Personat me Aftësi të Kufizuara.

